



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**KRYETARI**

---

Nr. 694/22 Prot.

Tiranë, më 24/11/2020

**V E N D I M**

**Nr. 127, Datë 24/11/2020**

**PËR**

**EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË USHTRUAR NË:  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E FINANCIMEVE DHE KONTRAKTIMEVE PËR  
FONDET E BE-SË DHE BANKËS BOTËRORE DHE DONATORËVE TË TJERË  
(CFCU), FONDI I SIGURIMIT TË DETYRUESHËM TË KUJDESIT  
SHËNDETËSOR, DEGA DOGANORE ELBASAN, INSTITUTI I SIGURIMEVE  
SHOQËRORE, FAF (AGROKREDIT) SHA, DREJTORIA E PËRGJITHSHME TË  
DOGANAVE, DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE, DREJTORIA E  
BUXHETIT DHE E BORXHIT NË MINISTRINË E FINANCIVE DHE EKONOMISË,  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E THESARIT NË MINISTRINË E FINANCIVE  
DHE EKONOMISË, DREJTORIA E PËRGJITHSHME E HARMONIZIMIT TË  
KONTROLLIT TË BRENDSHËM PUBLIK NË MINISTRINË E FINANCIVE DHE  
EKONOMISË, DREJTORIA E KONCESIONEVE NË MINISTRINË E FINANCIVE  
DHE EKONOMISË, INSTITUTI I SIGURIMEVE SHOQËRORE (TEMATIK  
PENSIONET E MINATORËVE),  
“PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMET E  
MËPARSHME, PËR AUDITIMET E EVADUARA NË PERIUdhËN 01.01.2019-  
31.12.2019.”**

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Përmbledhur të Auditimit dhe projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Buxhetit të Shtetit, shpjegimet e dhëna nga subjektet e audituara, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Drejtorisë së Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të Auditimit të mësipërm dhe mendimin e Drejtorit të Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 15, 25, 26 dhe 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Nga auditimi i ushtruar për zbatimin e rekomandimeve sipas Programit të Auditimit Nr.694 Prot, datë 16.07.2020 me objekt “Për Zbatimin e Rekomandimeve të lëna në Auditimet e mëparshme, për auditimet e evaduara në periudhën 01.01.2019-31.12.2019 rezultoi që nga ana e institucioneve të audituara janë marrë masa mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, të cilat në mënyrë të përmbledhur paraqiten si vijon:

Në 12 subjekte të audituara, janë rekomanduar nga KLSH gjithsej 338 masa, nga të cilat janë pranuar 290 masa ose rreth 86% dhe nuk janë pranuar 48 masa ose rreth 14%. Janë zbatuar plotësisht 94 prej tyre ose rreth 33%, janë në proces zbatimi 91 masa ose rreth 31%, janë zbatuar pjesërisht 23 ose rreth 8% dhe nuk janë zbatuar 78 masa ose rreth 28%.

Të analizuar sipas llojit të masave të rekomanduara, zbatimi i tyre rezulton:

A- Propozime për ndryshime apo përmirësime të legjislacionit në fuqi, janë rekomanduar nga KLSH gjithsej 7 masa, nga të cilat janë pranuar 6 masa ose rreth 86% dhe nuk është pranuar 1 masë ose rreth 14%. Nga 6 masat e pranuar është zbatuar plotësisht 1 prej tyre ose rreth 17%, janë në proces zbatimi 3 masa ose rreth 50% dhe nuk janë zbatuar 2 masa ose rreth 33%.

B- Masa organizative, janë rekomanduar nga KLSH gjithsej 232 masa, nga të cilat janë pranuar 200 masa ose rreth 86% dhe nuk janë pranuar 32 masa ose rreth 14%. Nga 220 masat e pranuar janë zbatuar plotësisht 55 prej tyre ose rreth 28%, janë në proces zbatimi 63 masa ose rreth 32%, janë zbatuar pjesërisht 15 prej tyre ose rreth 8% dhe nuk janë zbatuar 63 masa ose rreth 32%.

C- Masa për shpërblim dëmi, janë rekomanduar nga KLSH gjithsej 14 masa me vlerën 966,149 mijë lekë, nga të cilat janë pranuar 9 masa në vlerë 40,327 mijë lekë ose rreth 4% dhe nuk janë pranuar 5 masa me vlerë 924,875 mijë lekë ose rreth 96%. Nga 14 masat e pranuar janë zbatuar plotësisht 2 prej tyre në vlerë 600 mijë lekë, janë në proces zbatimi 4 masa në vlerë 38,809 mijë lekë ose rreth 4%, janë zbatuar pjesërisht 2 masa në vlerë 1,480 mijë lekë, dhe nuk është zbatuar 1 masë në vlerë 920,195 mijë lekë ose rreth 96%.

D- Masa për eliminimin e efekteve negative nga shpenzime të realizuara në kushte të paligjshmërisë, janë rekomanduar nga KLSH gjithsej 55 masa me vlerë 16,799,568 mijë lekë nga të cilat janë pranuar 50 masa në vlerë 16,387,621 mijë lekë ose rreth 98% dhe nuk janë pranuar 5 masa me vlerë 411,677 mijë lekë ose rreth 2%. Nga 50 masat e pranuar janë zbatuar plotësisht 11 masa në vlerë 372,450 mijë lekë ose rreth 2%, janë në proces zbatimi 20 masa në vlerë 6,629,671 mijë lekë ose rreth 40%, janë zbatuar pjesërisht 6 masa në vlerë 714,800 mijë lekë ose rreth 4% dhe nuk janë zbatuar 9 masa në vlerë 8,670,700 mijë lekë ose rreth 53%.

E- Masa për të ardhurat e munguara, është rekomanduar nga KLSH gjithsej 1 masë me vlerë 215,000 mijë lekë nga të cilat 1 masa është në proces në vlerë 215,000 mijë lekë.

F- Masa administrative, janë rekomanduar nga KLSH gjithsej 3 masa, nga të cilat janë pranuar 3 masa dhe 1 masë është zbatuar plotësisht

G- Masa disiplinore, janë rekomanduar nga KLSH gjithsej 12 masa, nga të cilat janë pranuar 8 masa ose 67% dhe nuk janë pranuar 4 masa ose 33%. Nga 12 masat e pranuar janë zbatuar plotësisht 8 masa dhe rezultojnë 4 të pazbatuara.

## **V E N D O S A:**

**I.** Të miratoj Raportin Përfundimtar të Përmbledhur<sup>1</sup> të Auditimit “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme” të ushtruar në Drejtoria e Përgjithshme e Financimeve dhe Kontraktiveve për Fondet e BE-së dhe Bankës Botërore dhe Donatorëve të tjerë (CFCU), Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, Dega Doganore Elbasan, Instituti i Sigurimeve Shoqërore, FAF (Agrokredit) Sha, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtoria e Buxhetit dhe e Borxhit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Përgjithshme e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Publik në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Koncesioneve në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Instituti i Sigurimeve Shoqërore (Tematik Pensionet e

---

<sup>1</sup> Raporti i përmbledhur i auditimit përbëhet nga 12 raporte auditimi sipas subjekteve

Minatorëve) sipas programit të auditimit nr 694 prot, datë 16.07.2020 me objekt “Për Zbatimin e Rekomandimeve të lëna në Auditimet e mëparshme, për auditimet e evaduara në periudhën 01.01.2019-31.12.2019”.

**II.** Të miratoj rikërkimin e zbatimit të rekomandimeve të pa zbatuara, të zbatuara pjesërisht, në proces zbatimi ose të papranuara sa vijon:

## **1. DREJTORIA E PËRGJITHSHME E FINANCIMEVE DHE KONTRAKTIMEVE PËR FONDET E BE, BANKËS BOTËRORE DHE DONATORËVE TË TJERË**

Auditimi në **Drejtorinë e Përgjithshme të Financimeve dhe Kontraktive për Fondet e Be, Bankës Botërore dhe Donatorëve të tjerë** është realizuar sipas Programit të Auditimit Nr.694 Prot, datë 16.07.2020 me objekt “Për Zbatimin e Rekomandimeve të lëna në Auditimet e mëparshme, për auditimet e evaduara në periudhën 01.01.2019-31.12.2019.

Në përfundim të misionit auditues në lidhje me verifikimin e dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga KLSH në *Drejtorinë e Përgjithshme të Financimeve dhe Kontraktive për Fondet e Be, Bankës Botërore dhe Donatorëve të tjerë* me shkresën e KLSH Nr.1443/16 prot, datë 17.09.2019, rezulton në mënyrë të përmbledhur, si më poshtë:

### **KONKLUZIONI I AUDITIMIT**

Nga auditimi tematik mbështetur në standardet e INTOSAI-t, Manualit të Përputhshmërisë, Manualit të ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve së KLSH-së, i kryer në *Drejtorinë e Përgjithshme të Financimeve dhe Kontraktive për Fondet e Be, Bankës Botërore dhe Donatorëve të tjerë*, rezultoi se për rekomandimet e pranuar niveli i zbatimit te tyre plotësisht ose proces zbatimi, është në vlerën 56%.

- Masa “Propozime për ndryshime apo përmirësime në legjislacionin në fuqi”: Është rekomanduar 1 masë, e cila nuk është pranuar nga subjekti.”

- Masa Organizative: Janë rekomanduar 44 masa organizative, nga të cilat janë pranuar 32 masa organizative, 10 masa organizative në proces zbatimi, 5 masa organizative janë realizuar, 1 masë organizative është realizuar pjesërisht dhe 16 masa organizative nuk janë realizuar, ndërkohë që 12 masa organizative nuk ishin pranuar.

- Masa për Elemimin e efekteve negative nga shpenzime të realizuara në kushte të paligjshmërisë në procedurat e prokurimit dhe parregullsive në menaxhimin financiar dhe sistemet e kontrollit: Janë rekomanduar 3 masa në vlerën 121,700 mijë lekë, nga të cilat janë pranuar 3 masa dhe janë në proces zbatimi 2 masa në vlerën 0 lekë dhe 1 masë nuk është zbatuar në vlerën 121,700 mijë lekë..

- Masa Disiplinore: Janë rekomanduar 2 masa, nga të cilat janë pranuar 2 masa, të cilat janë zbatuar.

- Masa “Për Punjonësit e Larguar”: Janë rekomanduar 2 masa, nga të cilat janë pranuar 2 masa dhe nuk është zbatuar asnjë, të cilat nuk mund të rikërkohen.

**Përsa më sipër rikërkohet që Drejtoria e Përgjithshme të Financimeve dhe Kontraktive për Fondet e BE, Bankës Botërore dhe Donatorëve të tjerë të marrë të gjitha masat e nevojshme me qëllim zbatimin e të gjitha rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara, të papranuara, të zbatuara pjesërisht, në proces zbatimi, si më poshtë:**

**A. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI.**

**Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve përcjellë me shkresën nr.1443/16 prot, datë 17.09.2019, nuk është pranuar rekomandimi si vijon:

**Rekomandimi 1.1:** NAO, në bashkëpunim me Drejtorinë Mbështetëse të NAO dhe CFCU të marrin masat për rishikimin e Marrëveshjeve të Implementimit, Operacionale dhe Manualin e Procedurave të Brendshme të CFCU, duke përcaktuar qartë sipas kuadrit ligjor përgjegjësitë e çdo strukture përbërëse të drejtorisë, gjatë fazës së prokurimit dhe zbatimit të kontratave, në dallim nga strukturat e njësisë IPA në institucionet përfituese.

## B. MASA ORGANIZATIVE

**Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve përcjellë me shkresën nr.1443/16 prot, datë 17.09.2019, nuk janë pranuar rekomandimet si vijon:

**Rekomandimi 1.1:** Nga CFCU, të merren masa për trajtimin e duhur të konfliktit të interesit, në çdo fazë të projekteve dhe nga dhe për të gjithë aktorët dhe palët e përfshira, në mënyrë që ky proces të mos mbetet një proces formal bazuar në vetëdeklarim, kjo me qëllim shmangien nga lista e vlerësuesve të personave të cilët direkt apo indirekt ndikojnë në krijimin e situatave të tilla ku procesi i prokurimit është formal në dukje dhe elementi i barazisë dhe transparencës vihet në diskutim.

**Rekomandimi 2.1:** Nga CFCU me përgjegjësinë e monitoruesit të procesit, të nxirren detyra konkrete bazuar në problematikën e evidentuar në rastet e mësipërme, për të luajtur një rol proaktiv në të gjitha fazat procesit të prokurimit për siguruar trajtim të njëtrajtshëm të rasteve të konsulentëve të rikontraktuar dhe vlerësimin e ndodhjes së tyre në konflikt interesi (gërma (a) e pikës 1.9) apo pozicion avantazhues ndaj konkurrentëve të tjerë. Në përputhje kjo me përcaktimet përkatëse në Rregulloret dhe Udhëzuesit e Bankës Botërore, në të gjitha projektet në vijim.

**Rekomandimi 3.1:** CFCU në bashkëpunim me RIG apo Komitetin e Drejtimit të Projektit, rast pas rasti sipas përcaktimeve të Manualit Operacional, të analizojë dhe vlerësojë problematikën e evidentuara në lidhje me vlerësimin jo të plotë e sipërfaqësor dhe në disa raste të pasakta i ofertuesve duke mos garantuar kushtet e një konkurrence të drejtë dhe transparente.

**Rekomandimi 3.2:** CFCU në bashkëpunim me ekspertët e Bankës Botërore të marrë masa për të rishikuar procesin e vendosjes së kriterëve për anëtarët e komisionit të vlerësimit, duke parashikuar paraqitjen e CV-ve të anëtarëve të propozuar që nuk kanë eksperiencë të mjaftueshme në vite pune dhe certifikime relevante, për të siguruar kapacitetet e nevojshme për një vlerësim të drejtë e profesional të ofertuesve në raport me natyrën, kompleksitetin dhe volumin e aktiviteteve që ofertuesit pritet të realizojnë.

**Rekomandimi 4.1:** Në zbatim të rolit dhe misionit të saj CFCU në bashkëpunim me Bankën Botërore të iniciojë rishikimin e procedurave dhe Udhëzimeve me qëllim parashikimin e kontrolleve për verifikimin e kredencialeve që vërtetojnë se firmat konkurruese dhe ekspertet që ata paraqesin, zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, organizative në përpjesëtim me natyrën, kompleksitetin dhe volumin aktiviteteve sipas termave të referencës së miratuara në zbatim të pikës 2.2 të Aneksit të Rregullores së Prokurimit.

**Rekomandimi 7.1:** Struktura përgjegjëse e CFCU për monitorimin dhe administrimin e procesit të prokurimit, në koordinim me Bankën Botërore, të nxjerrin një rregullore ku të sanksionohen afatet e çdo etape të rëndësishme të prokurimit të fondeve të përfituara nga marrëveshjet me BB, dhe ku të ketë përgjegjësi të qartë për nëpunësit dhe përfaqësuesit e përfituesve që sjellin vonesa në realizimin e këtyre etapave. Këto afate të reflektohen më pas në Manualin Operacional të çdo projekti.

**Rekomandimi 8.1:** CFCU duhet së pari të identifikojë situatën si një rast gabimi në planifikim dhe kontraktim si dhe të monitorojë dhe të sigurojë që fondet e rialokuara sa më sipër nuk kanë apo do të ndikojnë në cilësinë e komponentëve të tjerë të këtij projekti dhe të nxjerrë përgjegjësi të saktë lidhur me këtë deviacion material dhe të pajustificuar.

**Rekomandimi 8.2:** Të merren masa që në vijim, strukturat e CFCU-së të mos fasilitojë rialokime të fondeve ndërmjet komponentëve të projekteve me justifikimin se kanë mbetur fonde të lira nga kontraktime me vlera më të ulëta të nën komponentëve të tjerë në rastet kur nuk ka një propozim për një aktivitet të ri që të justifikojë alokimin.

**Rekomandim 9.1:** CFCU të marrë masat për kryerjen e një roli efektiv dhe proaktiv gjatë mbikëqyrjes së kontraktimit dhe zbatimit të kontratave të projekteve të Bankës Botërore, nëpërmjet raportimeve periodike mbi statusin e kontratave dhe adresimin në kohë të problematikave rast pas rasti, me qëllim shmangien e amendimeve të njëpasnjëshme pa një analizë të shkaqeve.

**Rekomandim 12.1:** Ministria e Financave dhe Ekonomisë të analizojë faktorët që kanë çuar në dështimin e procedurës së prokurimit për një vit si dhe mungesën e interesit nga operatorët ekonomikë, për të garantojë përmbushjen e kushteve të marrëveshjeve financiare ndërkombëtare, për të cilat Qeveria Shqiptare ka rënë dakord me donatorët, me qëllim parandalimin e këtij fenomeni për çertifikimin e pasqyrave financiare të 2018.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë të veçojë projektin FINREP nga projektet e tjera dhe të sigurojë çertifikimin e pasqyrave financiare të audituara të tij, nga një auditues i jashtëm që nuk është përfitues në këtë projekt nëpërmjet kontratave të asistencës teknike.

**Rekomandimi 15.1:** Nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë të merren masa konkrete administrative dhe ligjore për përgjegjësitë e cituara në këtë gjetje në mënyrë që të mos përsëriten situata me efekte negative jo vetëm financiare por edhe të imazhit të vendit përpara donatorëve evropiane.

**Rekomandimi 15.2:** NAO dhe Struktura Mbështetëse e NAO-s të përcjellin problematikën e vonesave të shkaktuara nga institucionet përfituese të projekteve, që kanë shkaktuar mos përfitimin e fondeve nga këto institucione, duke kërkuar nga titullarët respektiv marrjen e masave të menjëhershme për punonjësit e strukturave IPA që nuk kanë respektuar afatet në dorëzimin e dokumentacioneve, si dhe mos përgatitjen e tyre në përputhje me rregullat e PRAG sikundër orientojnë marrëveshjet ndërkombëtare.

**Rekomandimi 16.1:** CFCU të marrin masat për të eliminuar praktikën akomoduese dhe mbështetëse të deviacioneve që sjellin efekte negative në produktet e përfituara duke ndjekur me përgjegjësi afatet e paracaktuara dhe shmangien e situatave që rezultojnë me një nivel të ulët të disbursimit të fondeve, apo përqëndrimin të pagesave në fund të periudhës së implementimit të kontratës ndaj kontraktorit. Monitorimi i produkteve duhet të jetë një praktikë e vazhdueshme, dhe jo një formalitet i realizuar me anë të check -listave.

**Rekomandimi 17.2:** NAO si strukturë përgjegjëse për menaxhimin në tërësi të fondeve IPA, të iniciojë një inspektim të thelluar financiar për trajtimin e problematikës nëse janë përfshirë apo jo në termat e referencës elementët që sollën parregullsitë në pajisjet e dorëzuara si dhe përcaktimin e përgjegjësive jo vetëm administrative për strukturat që kanë sjellë prokurimin e pajisjeve jo funksionale.

**Rekomandimi 18.1:** CFCU, në bashkëpunim me NAO-n, si struktura përgjegjëse për monitorimin dhe menaxhimin e fondeve IPA, të marrin masat për unifikimin e procesit të marrjes në dorëzim e mallit dhe përcaktimin e bashkëpërgjegjësive së ekspertëve të fushës të kontraktuar për këtë shërbim në bashkëpunim me strukturat e CFCU, kjo për të garantuar që produktet e marra në dorëzim plotësojnë kushtet e kërkuara dhe kryejnë më së miri funksionet për të cilat janë prokuruar.

**Rekomandimi 19.1:** Sektori i Përgatitjes dhe Monitorimit të Kontratës në CFCU, të marrë masat për identifikimin e realizimit të objektivave sipas planifikimit të periudhës për çdo raport

progresi 6 mujor, dhe kryerjen e pagesës së ekspertëve sipas objektivave të realizuar prej tyre, në përputhje me Termat e Referencës, duke shmangur praktikat e mbivlerësimit të pagesave kundrejt punës së kryer prej tyre, pra që realizohet në kushtet kur për realizimin e një objekti kontraktori paguhet më tepër se plani fillestar në kontratë.

**Rekomandimi 19.2:** CFCU, të heq dorë nga rolin akomodues dhe të marrë masat për shqyrtim të nivelit të pagesave respektivisht me objektivat e planifikuar për tu kryer nga projekti, dhe shmangien e situatave në të cilat ditët e punës të planifikuara për një objektiv që është përfunduar, rialokohen nga vetë eksperti për realizimin e objektivave të tjerë duke përdorur edhe orët e dedikuara sipas planit të kontratës për objektivin e realizuar.

**Rekomandimi 19.3:** Për kontratën e Shërbimit e përfunduar “Mbështetje për Arsimin, Formimin Profesional dhe Trajnimin në Shqipëri”, për objektivat e raportuara në këtë Raport si të pakryera dhe të papërfshira në planin e periudhës shtesë 2 mujore, CFCU të marrë masat për shqyrtimin e hollësishëm të raportit final dhe kryerjen e pagesës finale ndaj kontraktorit në bazë të objektivave të realizuar, pavarësisht timesheet-s të vendursa në dispozicion; dhe gjithashtu në bashkëpunim edhe me strukturën e NAO-s të iniciohet një kontroll pranë shkollave profesionale për “Kontratën e furnizimit për Arsimin Profesional” për evidentimin e funksionimit të pajisjeve në përputhje me specifikimet e kontratës, në kushtet kur marrja në dorëzim e tyre u krye nga vetë punonjësit e këtyre shkollave, përpara lëshimit të final acceptance ndaj kontraktorit.

**Rekomandimi 19.4:** CFCU, në rolin e saj si monitoruese e zbatimit të kontratës, të synojë minimizimin e rasteve të zëvendësimit të ekspertëve me të cilët është fituar projekti. Në rastet e zëvendësimit të ekspertëve të marrë masat për garantimin e propozimit të ekspertit të ri brenda 15 ditëve nga kontraktori, dhe në rastet kur kjo nuk arrihet, apo eksperti i propozuar nuk rezulton të gëzojë eksperiencën e duhur, të kërkohet zëvendësimi i ekspertit nga kontraktori, kostot për të cilin do të mbulohen nga vetë kontraktori në mënyrë që të mos cënohet ecuria e kontratës apo të rezultojnë me mendime të afatit përfundimtar të projektit, deri në zgjedhjen e ekspertit me eksperiencën sipas kontratës.

**Rekomandimi 20.1:** Në zbatim të rolit të saj si mbikëqyrëse dhe monitoruese për zbatimin e kontratave IPA, CFCU të marrë masat për kryerjen e kontrolleve mbi implementimin e plotë dhe në kohë të objektivave të kontratës, identifikimin e devijimeve nga plani i periudhës dhe përgjegjësi që kanë qenë shkak për këto vonesa, me qëllim marrjen e masave për zgjidhjen e tyre dhe raportimin e parregullsive pranë NAO.

**Rekomandimi 20.2:** CFCU në bashkëpunim me institucionet përfituese të projekteve IPA, gjatë miratimit të Inception Report të evidentojnë afatet e nën objektivave të përcaktuar në kontratë për tu realizuar sipas komponentëve dhe aplikimin e produkteve lehtësisht të matshëm prej tyre, me qëllim shmangien e praktikave në të cilat afati i tyre përkon me afatin përfundimtar të projektit, situatë kjo e cila e vështirëson raportimin e progresit të arritur për projektin total.

**Rekomandimi 22.1:** CFCU, si strukturë përgjegjëse për monitorimin e kontratave, në bashkëpunim me NAO-n të marrë masat për rishikimin e marrëveshjeve mes saj dhe njësisë IPA në institucionet përfituese me qëllim përcaktimin e afateve për kryerjen e miratimit të dokumentacioneve të ndryshme nga ana e SPO si raporte progresi, shqyrtim të kandidaturave të ekspertëve, etj.

**Rekomandimi 23.1:** CFCU, të marrë masat për identifikimin e rasteve në të cilat nuk është respektuar afati për dorëzimin e raportit progresit në përputhje me kontratën, dhe adresimin e tyre pranë NAO-s, me qëllim analizimin rast pas rasti dhe nxjerrjen e përgjegjësi për devijim të planifikimit buxhetor për efekt të TVSH-së së lidhur me kontratën, në buxhetin e miratuar të institucionit përfitues.

**Rekomandimi 24.1:** Sektori i Menaxhimit Financiar pranë CFCU, të përgatisë një udhëzues për trajtimet fiskale të cilat kanë implikime në realizimin e pagesave të kontraktorëve nën

programet IPA por edhe ato të Bankës Botërore. Të bashkëpunohet me strukturat e DPT për vlerësimin sa më të saktë të situatave dhe trajnimin e punonjësve të strukturave të menaxhimit financiar pranë CFCU.

**Rekomandimi 24.2:** CFCU në bashkëpunim me institucionet përfituese dhe kontraktorët, të marrin masat për shmangien e vonesave në dorëzimin dhe aprovimin e raporteve të ndërmjetme në mënyrë që të mos ketë devijime/vonesa në deklarin dhe pagimin e TVSH-së për periudhën në të cilën është kryer shërbimi/malli/punimi.

**Rekomandimi 27.1:** CFCU të marrë masat për kryerjen e trajnimeve në bazë të nevojave specifike në njësitë më problematike, lidhur me procedurat e tenderimit apo monitorimit të kontratës dhe asistimin e tyre në rastet kur këto njësi rezultojnë jo efektive në përdorimin e kohës në dispozicion për përgatitjen e dosjes së tenderimit, apo reflektojnë dobësi në monitorimin e saktë të progresit të projektit.

**Rekomandimi 28.1:** CFCU, në bashkëpunim me Drejtorinë e Fondit Kombëtar dhe Drejtorinë e Thesarit dhe Borxhit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, të marrin masat për raportimin e drejtë të shpejtimeve të vitit të projekteve IPA për efekt të treguesve fiskal, duke reflektuar vlerën e saktë të investimeve të huaja në rritje të aktiveve.

**Rekomandimi 29.1-:** CFCU, në bashkëpunim me Drejtorinë e Fondit Kombëtar dhe Drejtorinë e Thesarit dhe Borxhit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, të marrin masat për të kryer raportimin e saktë të projekteve (pjesa e parapagimeve dhe garancisë) në pasqyrën e treguesve fiskal bazuar në vlerën reale të investimit të përfituar, duke shmangur mbivlerësimin apo nënvlerësimin në periudhat e ndryshme të raportimit.

## D. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE NGA SHPENZIME TË REALIZUARA NË KUSHTE TË PALIGJSHMËRISË NË PROCEDURAT E PROKURIMIT DHE PARREGULLSIVE NË MENAXHIMIN FINANCIAR DHE SISTEMET E KONTROLLIT.

**Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve përcjellë me shkresën nr.1443/16 prot, datë 17.09.2019, **nuk është pranuar, janë në proces rekomandimet si vijon:**

**Rekomandimi 1.1:** Ministri i Financave dhe Ekonomisë pasi të analizojë konstatimet e këtij auditimi të marra masa për përcaktimin e përgjegjësive konkrete që kanë çuar në ndërperjen e pagesave të kontratës nga delegacioni, dhe detyrimin për kthimin e pagesave kundrejt Bashkimit Europian, si dhe për papërgjegjshmërinë e treguar nga strukturat përgjegjëse për menaxhimin e projekteve IPA për të adresuar saktë, në mënyrë transparente dhe në kohë problematikën e konstatuar.

**Rekomandimi 1.2:** NAO, në bashkëpunim me CFCU të marrë masa që në të ardhmen çdo pretendim i konkurentëve në procedurat e tenderimit të shikohet me kujdes dhe përgjegjshmëri të lartë profesionale në mënyrë që situata të tilla të mos përsëriten.

**Rekomandimi 1.3:** NAO, në bashkëpunim me Drejtorinë e Fondit Kombëtar të përfshijnë procedurat e rikuperimit të fondeve në udhëzuesit përkatës, duke identifikuar qartë momentin e kthimit të fondeve nga përfituesi, planifikimin e tyre që në fazën PBA dhe Buxhetin Vjetor, pavarësisht se korrigjimi faktik me delegacionin do të kryhet në momentin e mbylljes së llogarive të programit IPA, ku në rastin konkret shuma prej 1,013,688 Euro, tashmë i konfirmuar si detyrim i shtetit shqiptar ndaj delegacionit.

## 2. FONDI I SIGURIMIT TË DETYRUESHËM TË KUJDESIT SHËNDETËSOR

Auditimi në **Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor** është realizuar sipas Programit të Auditimit Nr.694 Prot, datë 16.07.2020 me objekt “Për Zbatimin e

Rekomandimeve të lëna në Auditimet e mëparshme, për auditimet e evaduara në periudhën 01.01.2019-31.12.2019” dhe duke u bazuar në punën e grupit të auditimit që e ushtroi auditimin në F.S.D.K.SH sipas programit Nr.381/1 Prot., datë 05.05.2020.

Në përfundim të misionit auditues në lidhje me verifikimin e dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga KLSH në **Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor** me shkresën e KLSH nr. 1444/15 prot., datë 19.09.2019, rezulton në mënyrë të përmbledhur, si më poshtë:

## **KONKLuzioni I AUDITIMIT**

Nga auditimi bazuar në punën e grupit të auditimit sipas programit Nr.381/1 Prot., datë 05.05.2020 mbështetur në standardet e INTOSAI-t, Manualit të Përputhshmërisë, Manualit të ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve së KLSH-së, i kryer në Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, rezultoi se për rekomandimet e pranuar nivelin e zbatimit të tyre plotësisht, në proces zbatimi ose pjesërisht, është në vlerën 86%.

Në subjektin e audituar, janë rekomanduar gjithsej (37) masa. Konstatuam se nga (37) masat e rekomanduara dhe të pranuar janë zbatuar plotësisht 9 prej tyre ose 24% , pjesërisht 11 masa ose 30%, në proces 12 masa ose 32% dhe nuk janë zbatuar 5 masa ose 14%.

- Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 23 masa organizative, nga të cilat rezulton: janë realizuar 5 masa; janë realizuar pjesërisht 8 masa; janë në proces realizimi 7 masa dhe janë pa realizuar 3 masa organizative.

- Për shpërbllim dëmi është rekomanduar 1 masë në shumën 948 mijë lekë, e cila është pranuar dhe rezulton në proces realizimi në vlerën 948 mijë lekë.

- Masa për eliminimin e paligjshmërive dhe mosveprimeve të drejtuesve të institucionit, shoqëruar me efekteve negative në administrimin e fondeve nën skemën e kujdesit shëndetësor, janë lënë 11 rekomandime me një vlerë prej 1,954.8 milion lekë, të cilat janë pranuar nga FONDI dhe rezulton se: janë realizuar 3 rekomandime në shumën 343 milion lekë; janë realizuar pjesërisht 3 rekomandime në shumën 714,8 milion lekë; janë në proces realizimi 3 rekomandime në shumën 716 milion lekë dhe nuk janë realizuar 2 rekomandime në shumën 181 milion lekë.

- Të ardhura të munguara, është rekomanduar një masë në vlerën 215 milion lekë, e cila është në proces realizimi.

- Masat disiplinore për personat përgjegjës nga ana e KLSH janë lënë për personat e larguar nga institucioni, për të cilët nuk mund të rikërkohet zbatimi i këtij rekomandimi.

**Përsa më sipër rikërkohet që Fondi I Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor të marrë të gjitha masat e nevojshme me qëllim zbatimin e të gjitha rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara, të papranuara, të zbatuara pjesërisht, në proces zbatimi, si më poshtë:**

### **B. MASA ORGANIZATIVE**

**1.Gjetje nga auditimi** Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve përcjellë me shkresën nr. 1444/15 prot., datë 19.09.2019, rezultuan të pazbatuara, të papranuara, të zbatuara pjesërisht, në proces zbatimi rekomandimet, si vijon:

**Rekomandimi 1.2:** Ministria e Financës dhe Ekonomisë dhe MSHMS, në bashkëpunim me Strukturat drejtuese të Fondit të Sigurimit të Kujdesit Shëndetësor, të bëjnë të mundur **rishikimin e kontratës** konçesionare të financimit me PPP, me shoqërinë konçesionare të



“S s” shpk, në mënyrë që të **rifformatohen grupet e kompleksiteteve sipas llojit të ndërhyrjes dhe të rifformatohen paisjet e domosdoshme për çdo lloj diagnoze si dhe të strukturohet qartë çmimi për çdo paketë duke eliminuar kostot që mbulohen nga strukturat spitalore (si psh energji, ujë etj), me qëllim ofrimin e një shërbimi eficient, efektiv dhe ekonomik.**

**Rekomandimi 2.1:** Struktura drejtuese të Fondit/ Drejtoria e Shërbimit Parësor e Spitalor/ DAPSHET, të bëjnë të mundur **përmirësimin e udhëzimit nr.26**, datë 07.11.2014 “Për administrimin e regjistrit kombëtar të paketave”, ndryshuar me udhëzimin nr.1, datë 22.01.2015 (për dializën), me udhëzimin nr.7, datë 10.10.2016 (urgjencat e kardiologjisë), në mënyrë që edhe paketat e shërbimit të kardiologjisë dhe kardiokirurgjisë të regjistrohet në regjistrin kombëtar në kohë e me dokumentacion të miratuar, duke përcaktuar në të edhe sanksione për ata subjekte e individë që i shkelin legjislacionin.

**Rekomandimi 3.3:** Të hartohen procedura për saktësimin e protokolleve, në bashkëpunim me shërbimet universitare dhe MSHMS, në mënyrë që të justifikohen në paketën e shërbimit të Dializës, seancat mbi 13 herë në muaj.

**Rekomandimi 4.1:** Strukturat drejtuese të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe MSHMS, në bashkëpunim me Strukturat drejtuese të Fondit të Sigurimit të Kujdesit Shëndetësor, të bëjnë të mundur **rishikimin e kontratës koncesionare me PPP** të shërbimit bazë **Check-up**, me shoqërinë koncesionare “**P L L**” shpk, për të gjitha problematikat e konstatuara për kohëzgjatjen e deritanishme por edhe mbi një analizë të thelluar dhe shteruese të probleme që lidhen me implementimin e kësaj kontrate në vijimësi. Të ketë një vendimarrje të kujdesshme dhe shteruese pasi ndërhyrjet e shpeshta tregojnë për nivel të ulët të seriozitetit të punës së strukturave shtetërore.

**Rekomandimi 4.2:** Ministri i Financave dhe Ekonomisë të analizojë vendimarrjen e Drejtorisë Teknike pranë DPT, lidhur me interpretimin e gabuar në lidhje me çështjen e **TVSH**<sup>së</sup> me të cilin faturohet ky shërbim, duke siguruar trajtimin e kujdesshëm fiskal të kësaj kontrate brënda kornizës ligjore.

**Rekomandimi 6.1:** Këshilli Administrativ, në përmbushje të detyrimeve ligjorë të marrë të gjitha masat e nevojshme më qëllim zgjedhjen e Zëvendës Kryetarit të KAtë FSDKSH-së si dhe Titullari i institucionit të marrë të gjitha masat e nevojshme për:

- a) Sigurimin e pjesëmarrjes së Përfaqësuesve të Katedrës së Farmakologjisë në Fakultetin e Mjekësisë në komisionet e hartimit të Listës së Barnave të Rimbursueshëm si dhe
- b) Të realizojë hartimin e një metodologji e cila të udhëheqë punën e Komisioneve Teknike në lidhje me përcaktimin e masës së mbulimit dhe marzhet e fitimit të barnave të listës të cilat në vijim dërgohen në Ministrinë e Shëndetësisë *dhe Mirëqenies Sociale dhe procedim të mëtejshëm pranë Këshillit të Ministrave.*

**Rekomandimi 6.2:** Të merren masa për reflektimin e ndryshimeve në Vendimin nr.36, datë 19.11.2013 të KA, të ndodhura në zbatim të rekomandimeve të KLSH-së të cilat janë pranuar dhe zbatuar nga FSDKSH dhe përkatësisht në pikat 7,8,9,11,12 dhe 16 të këtij vendimi.

**Rekomandimi 7.1:** Këshilli Administrativ të marrë masa për përmirësim e Statutit të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë, në lidhje me parashikimin e kompetencave të punësimit, duke eliminuar problematikat e konstatuara.

**Rekomandimi 7.2:** Titullari i FSDKSH-së, të marrin të gjitha masat për zbatimin e plotë të Urdhrit Nr.577, datë 01.11.2018 për ngritjen e grupit të punës “Për rishikimin e sistemit të pagave të punonjësve të Fondit”. Rishikim i cili duhet të realizohet bazuar në një proces korekt për përcaktimin e specialitetit dhe arsimit të kërkuar për çdo pozicion pune në strukturën organizative të Fondit.

**Rekomandimi 7.3:** Të merren masa që të formalizohet në çdo rast dorëzimi i detyrës nga punonjësit në rastin e ndërprerjeve të marrëdhënieve të punës por edhe të transferimeve brenda strukturave të FSDKSH.

**Rekomandimi 8.1:** Titullari i FSDKSH-së dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore, të marrin masat e menjëhershme për plotësimin e dosjeve të personelit sipas kërkesave ligjore, për vlerësimet vjetore të punonjësve në mënyrë të rregullt dhe organizimin e trajnimeve profesionale të tyre për çdo Drejtor në Drejtorinë e Përgjithshme të Fondit dhe për çdo Drejtor apo Degë Rajonale.

**Rekomandimi 9.1:** Nga ana e Titullarit të FSDKSH-së, të merren masat për rishikimin e rregullores për veprimtarinë e KSHA dhe paraqitjen e saj për miratim në Këshillin Administrativ, duke e konceptuar KSHA si një instrument ndihmës për Drejtorinë e Përgjithshme të Fondit dhe jo si një institucion i pavarur.

**Rekomandimi 9.2:** Të përcaktohen instrumenta kontrolli mbi veprimtarinë e Komitetit të Shqyrtimit Administrativ si dhe të merren masa administrative për çdo shkëlqje të konstatuar

**Rekomandimi 10.1:** Strukturat drejtuese të MFE, si detyrim i nenit 4/2 të ligjit organik të buxhetit, në të cilin përcaktohet që kjo ministri vlerëson dhe miraton paraprakisht të gjitha projektet koncesionare dhe të partneritetit publik privat (PPP), si dhe Strukturat drejtuese MSHMS, të cilat përcaktojnë politikat e programeve të shëndetësisë, të bëjnë të mundur që ky institucion të ketë programe a nënprograme buxhetore më vete, në mënyrë që strukturat menaxhuese të këtij institucioni të mund të parashikojnë drejt si rimbursimin e barnave, por edhe të gjitha shpenzimet dhe paketat spitalore, në mënyrë që të programohen dhe likuidohen në kohë të gjitha llojet e shpenzimeve spitalore, duke shmangur detyrimet e prapambetura në këtë program.

**Rekomandimi 11.1:** Strukturat drejtuese të Fondit, të marrin masa për ndryshimin e nenit 8 pika 2 të Kontratës për qarkullimin e Barnave që Rimbursohen për vitin 2018 për të gjithë subjektet që rilidhin kontratë me FSDKSH-në për të eliminuar problematikat e konstatuara.

**Rekomandimi 11.2:** Nga titullari i FSDKSH të merren masa me qëllim, hartimin dhe ushtrimin e kontrollit me bazë risku, organizimin e kontrolleve të plota me inventarizim me cikël të mbyllur, si dhe koordinimin e gjithë aktivitetit të strukturave të Fondit për zbatimin e skemës së sigurimit shëndetësor.

**Rekomandimi 11.3:** FSDKSH, në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, me qëllim minimizimin e riskut të qarkullit të barnave të skaduara në treg të ndërmarrë masa që brenda një periudhe kohore deri në 1 (në muaj) nga momenti i lidhjes së kontratës ndërmjet FSDKSH-së me importuesit farmaceutikë, të bëhet i mundur depozitimin i barnave të skaduara në ambiente të veçuara të përcaktuara me ligj, larg Depove Farmaceutike. Pjesëmarrja e FSDKSH-së në “Komisionin e Asgjësimit të Barnave të Skaduara” është e domosdoshme dhe e nevojshme.

**Rekomandimi 12.1:** Strukturat Drejtuese të FSDKSH-së, në bashkëpunim me institucionet e tjera si Agjencia e Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, Ministria e Shëndetësisë, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave/ Ministria e Financave të marrë nismë ligjore për ofrimin e informacionit me qëllim ushtrimin e kontrollit me cikël të mbyllur (Doganë-AKB-Depo-Rrjet Farmaceutik) mbi Listën e Barnave të Rimbursuara në Republikën e Shqipërisë si dhe ristrukturimin e Programit Informatik të Fondit me qëllim realizimin e këtij procesi.

**Rekomandimi 13.3:** Drejtoria e Kontrollit të marrin të gjitha masat e nevojshme me qëllim shmangien e problematikave në identifikimin e barnave të skaduara duke realizuar edhe hartimin e Dokumentit Unifikues në lidhje me kontrollin e ushtruar mbi barnat e skaduara duke përfshirë të gjithë periudhën e kontrollit.

**Rekomandimi 14.1:** Titullari i FSDKSH-së, të marrë masat e nevojshme që urdhrat për “Për përcaktimin e kufizimeve në përdorimin, sasinë dhe kohëzgjatjen e trajtimit me barna të LBR 2018”, të shoqërohen me një studim të efekteve financiare të pritshme me qëllim përdorimin e fondeve publike, në mënyrë të ligjshme dhe efektive.

**Rekomandimi 17.1:** Drejtoria Ekonomike, të bëjë analizën e të gjithë debitorëve pa shpresë arkëtimi me dokumentacionin përkatës për krijimin dhe ndjekjen e tyre, e cila të relatohet edhe në MFE për mënyrën e procedimit në pasqyrat financiare të viteve në vazhdim. Ndërkohë në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë si dhe ISSH, të ndjekë ecurinë e shumës debitore prej **215 milion lekë**, detyrim i ISSH, i pa derdhur në FSDKSH që nga viti 2012 (me gjithë rekomandimet e vazhdueshme nga KLSH në të dy institucionet).

**Rekomandimi 18.1:** Titullari i institucionit, të marrë të gjitha masat me qëllim që të eliminohen parregullsitë e konstatuara si dhe në përfundim të çdo kontrate për mallra, pune dhe shërbime duhet të përgatitet një raport përmbledhës për cilësinë e zbatimit të saj, problemet e hasura gjatë zbatimit dhe masat e marra për zgjidhjen e tyre.

**Rekomandimi 20.1:** Titullari i institucionit, të marrë të gjitha masat e nevojshme me qëllim, vënen në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore në drejtim të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit për të gjitha mangësitë e konstatuara.

**Rekomandimi 21.1:** Titullari i institucionit të marrë të gjitha masat e nevojshme me qëllim që, informacioni i ofruar nga të gjithë dhënësit e tij, të jetë i plotë dhe i saktë me qëllim kontrollin e risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive të strukturave që ata drejtojnë.

**Rekomandimi 23.1:** Nga Këshilli i Administrimit, të analizohet dhe nxirret përgjegjësia administrative për mos marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, të cilat kanë sjellë përkeqësim të situatës financiare të institucionit dhe rritje të shpenzimeve buxhetore në skemën e rimbursimit të ilaceve, manaxhimit të shërbimeve nën kontratat koncesionare të partneritetit publik privat, të krijimit të detyrimeve të prapambetura etj.

#### C. MASA SHPËRBLIM DËMI

**Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve përcjellë me shkresën nr. nr. 1444/15 prot., datë 19.09.2019, rezultoi në proces zbatimi rekomandimet, rekomandimi si vijon:

**Rekomandimi 1.1:** Nga Drejtoria e Financës të merren masat për rikthimin e vlerës prej **948 mijë lekë** të përfituar padrejtësisht si shpërblim vjetërsie.

#### D. MASA PËR ELIMIMIN E PALIGJSHMËRIVE DHE MOSVEPRIMEVE TË DREJTUESVE TË INSTITUCIONIT, SHOQËRUAR ME EFEKTEVE NEGATIVE NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE NËN SKEMËN E KUJDESIT SHËNDETËSOR.

**Gjetje nga auditimi** Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve përcjellë me shkresën nr. 1444/15 prot., datë 19.09.2019, rezultuan të pa zbatuara, të zbatuara pjesërisht dhe në proces zbatimi rekomandimi, si vijon:

**Rekomandimi 1.1:** Strukturat Drejtueses të FSDKSH-së, të marrin masa për ndjekjen e kujdesshme të proceseve gjyqësore për largimet e padrejta nga puna në mënyrë që të minimizohen efektet negative për buxhetin e institucionit. Në të gjitha rastet të nxirret përgjegjësia direkte për ndërprerjet e marrëdhënieve të punës në kundërshtim me kërkesat e Kodit të Punës dhe me kontratën individuale të lidhur me punëmarrësit.

**Rekomandimi 1.2:** Ministria e Financës dhe Ekonomisë dhe MSHMS, në bashkëpunim me Strukturat drejtuese të Fondit të Sigurimit të Kujdesit Shëndetsor, të bëjnë të mundur **rishikimin e kontratës** koncesionare të financimit me PPP, me shoqërinë koncesionare të “S s” shpk, në mënyrë që të **rifformatohen grupet e kompleksiteteve sipas llojit të ndërhyrjes dhe të rifformatohen paisjet e domosdoshme për çdo lloj diagnoze si dhe të strukturohet qartë çmimi për çdo paketë duke eliminuar kostot që mbulohen nga strukturat spitalore (si psh energji, ujë etj), duke e futur këtë shërbim eficient dhe efektiv edhe me ekonomikitet.**

**Rekomandimi 3.1:** Të ketë një vendimarrje të kujdesshme dhe shteruese për të minimizuar kostot e këtij shërbimi.

**Rekomandimi 4.1:** Monitorimi i paketave të realizohet mbi një analizë mujore e vjetore midis paketave të shërbimeve spitalore të regjistruara, paketave të realizuara, paketave të monitoruara dhe të likuiduara, në mënyrë që të garantohet saktësia e shërbimeve që do të mbulohen nga shteti.

**Rekomandimi 5.1:** Strukturat drejtuese të Fondit, të marrin masa për të eliminuar problematikat e konstatuara.

**Rekomandimi 6.1:** Titullari i FSDKSH-së, të marrë masat e nevojshme që të mos përsëriten situata të tilla që sjellin efekte negative në skemën e rimbursimit.

**Rekomandimi 9.1:** Të merren të gjitha masat e nevojshme për eliminimin e këtyre situatave, me qëllim dërgimin e menjëhershëm për zbatim të vendimeve të KSHA, njësave vartëse të ngarkuara për zbatimin e këtyre vendimeve, me qëllim eliminimin e efekteve negative në buxhet.

**Rekomandimi 10.1:** Titullari i FSDKSH-së, si përgjegjës për sigurimin e normalitetit të procesit administrativ, të marrë masat e nevojshme që, çdo drejtori e FSDKSH-së të përmbushë detyrimet e lindura nga Ligji dhe kuadri rregullator i institucionit. Programimi i kontrolleve vjetore dhe mujore të bëhet në përputhje me kapacitetet e strukturave por edhe në përmblyshje të objektivave institucionale.

## E. TË ARDHURA TË MUNGUARA PËR FSDKSH-në

**Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve përcjellë me shkresën nr. nr. 1444/15prot., datë 19.09.2019, rezultoi në proces zbatimi rekomandimi, si vijon:

**Rekomandimi 1.1:** Struktura Drejtuese e FSDKSH/Drejtoria Ekonomike, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonominë, si dhe Strukturat drejtuese të ISSH, të ndjekë ecurinë dhe sistemimin e shumës debitore prej **215 milion lekë**, detyrim i ISSH, i pa derdhur në FSDKSH që nga viti 2012

## 3. DEGA DOGANORE ELBASAN

Auditimi në **Degën Doganore Elbasan** është realizuar në bazë të Programit të Auditimit Nr.694 Prot, datë 16.07.2020 me objekt “Për Zbatimin e Rekomandimeve të lëna në Auditimet e mëparshme, për auditimet e evaduar në periudhën 01.01.2019-31.12.2019”

Në përfundim të misionit auditues në lidhje me verifikimin e dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga KLSH në Degën Doganore Elbasan me shkresën prot 1447/12 nr, datë 02.10.2019, rezulton në mënyrë të përmbledhur, si më poshtë:

## KONKLUZIONI I AUDITIMIT

Nga auditimi tematik i realizuar në bazë të Programit të Auditimit Nr.694 Prot, datë 16.07.2020 mbështetur në standardet e INTOSAI-t, Manualit të Përputhshmërisë, Manualit të ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve së KLSH-së, i kryer në Degën Doganore Elbasan, rezultoi se për rekomandimet e pranuar niveli i zbatimit të tyre plotësisht, në proces zbatimi ose pjesërisht, është në vlerën 100%.

Në subjektin e audituar, janë rekomanduar gjithsej (17) masa, nga të cilat janë pranuar (16) masa, nuk është pranuar (1) masë. Konstatuam se nga (16) masat e rekomanduara dhe të pranuar janë zbatuar plotësisht 12 prej tyre, pjesërisht 2 masa ose 12.5%, konsiderohen në proces zbatimi 2 masa, ose 12.5%.

- Masa organizative, janë lënë 6 rekomandime nga të cilat: janë pranuar dhe janë zbatuar 5 rekomandime, është pranuar dhe është në proces zbatimi 1 rekomandim

- Në lidhje me masat për shpërblimin e dëmit ekonomik të shkaktuar janë lënë 5 masa në vlerë totale 39,972 mijë lekë, 2 rekomandime janë zbatuar pjesërisht në vlerën 1,480 mijë lekë, 2 rekomandime janë në proces zbatimi në vlerën 37,729 mijë lekë dhe nuk është pranuar 1 rekomandim në vlerën 764 mijë lekë.

- Nga 5 masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet të fondeve publike të rekomanduara gjithsej për vlerën 29,450 mijë lekë, 5 janë zbatuar në vlerën 29,450 mijë lekë mijë lekë.

- Masat disiplinore për personat përgjegjës nga ana e KLSH janë lënë si rekomandim në diskrecion të subjektit dhe konsiderohen të pranuar për sa kohë nuk është shprehur.

**Për sa më sipër rikërkojmë që Dega Doganore Elbasan të marrë të gjitha masat e nevojshme me qëllim zbatimin e të gjitha rekomandimeve që rezultuan të pa zbatuara, të zbatuara pjesërisht, në proces zbatimi ose të papranuara, si më poshtë:**

## B. MASA ORGANIZATIVE

**Gjetje nga auditimi** Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve përcjellë me shkresën prot 1447/12 nr, datë 02.10.2019, rezultuan të pa zbatuara, të zbatuara pjesërisht, në proces zbatimi ose të papranuara, **si vijon:**

**Rekomandimi 3.1** Dega Doganore në bashkëpunim me DPD dhe institucionet e tjera ligje zbatuese të përmendura në udhëzimin Nr.4 datë 07.04.2016 të D.P. Doganave “Për rikuperimin dhe kontabilizimin e Borxhit Doganor dhe Akcizes” i ndryshuar, të marrin masa konkrete dhe efektive për të zgjidhur sa më shpejt rrugën ligjore për rikuperimin e borxhit në shumën prej 232.584.641 lekë, nëpërmjet krijimit të akt marrëveshjeve të reja me subjektet doganore si dhe rritjes së bashkëpunimit me institucionet e tjera, për të bërë të mundur rikuperimin e tij.

## C. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

**Gjetje nga auditimi** Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve përcjellë me shkresën prot 1447/12 nr, datë 02.10.2019, rezultuan të pa zbatuara, të zbatuara pjesërisht, në proces zbatimi ose të papranuara, **si vijon:**

**Rekomandimi 1:** Të ndiqen të gjitha rrugët ligjore me qëllim analizimin dhe nxjerrjen e vendimeve administrative për kontabilizimin dhe më pas arkëtimin e detyrimeve doganore në shumën prej **34.912.345** leke.

**Rekomandimi 2:** Të ndiqen të gjitha rrugët ligjore me qëllim analizimin dhe nxjerrjen e vendimeve administrative për kontabilizimin dhe më pas arkëtimin e detyrimeve doganore dhe gjobave doganore në shumën prej **1.487.732** lekë.

**Rekomandimi 3:** Të ndiqen të gjitha rrugët ligjore me qëllim rishikim vendimesh administrative në shumën totale prej **764.286** lekë (për 5 raste të konstatuara)

**Rekomandimi 4:** Sektori i Akcizës të kërkojë arkëtimin e detyrimit doganor dhe sanksioneve doganore, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr.61/2012 “Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë”, duke kryer verifikime dhe kontrole specifike pranë regjistrave të kontabilitetit, me qëllim arkëtimin e detyrimit doganor të konstatuar në shumën totale prej **1.808.354** lekë (për 8 raste)

**Rekomandimi 5:** Dega doganore në bashkëpunim me DPD, të marrë masa për kontabilizimin dhe zbatimin në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit më qëllim arkëtimin e tatimit mbi të ardhurat personale në shumën prej **499.071** lekë.

#### **4. INSTITUTI I SIGURIMEVE SHOQËRORE**

Auditimi në **Institutin e Sigurimeve Shoqërore** është realizuar në bazë të Programit të Auditimit Nr.694 Prot, datë 16.07.2020 me objekt: Verifikimit i zbatimit të rekomandimeve të dërguara në Institutin e Sigurimeve Shoqërore, Tiranë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit.

Në përfundim të misionit auditues në lidhje me verifikimin e dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga KLSH në Institutin të Sigurimeve Shoqërore, Tiranë me shkresën me shkresën nr.1445/5 prot., date 22.08.2019, rezulton në mënyrë të përmbledhur, si më poshtë:

#### **KONKLUZIONI I AUDITIMIT**

Nga auditimi i tematik mbështetur në standardet e INTOSAI-t, Manualit të Përputhshmërisë, Manualit të ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve së KLSH-së, i kryer në Institutin e Sigurimeve Shoqërore, rezultoi se për rekomandimet e pranuar niveli i zbatimit të tyre plotësisht, në proces zbatimi ose pjesërisht, është në vlerën 83%.

Në subjektin e audituar, janë rekomanduar gjithsej (23) masa, nga të cilat janë pranuar (22) masa dhe nuk është shprehur për (1) masë, atë disiplinore e cila nga KLSH është lënë në diskrecion të subjektit e për pasojë konsiderohet e pranuar dhe e zbatuar. Konstatuam se nga (23) masat e rekomanduara dhe të pranuar janë zbatuar plotësisht 15 prej tyre ose 65% , pjesërisht 1 masë, ose 4%, në proces 3 masa ose 14% dhe nuk janë zbatuar 4 masa ose 17%.

- Nga 22 masa organizative të rekomanduara, janë pranuar 22 masa organizative, nga të cilat 14 masa janë të zbatuara, 3 masa rezultojnë në proces zbatimi, 1 masë rezulton e zbatuar pjesërisht dhe 4 masa rezultojnë të pazbatuara.

**Për sa më sipër rikërkojmë që Instituti i Sigurimeve Shoqërore të marrë të gjitha masat e nevojshme me qëllim zbatimin e të gjitha rekomandimeve që rezultuan të pa zbatuara, pjesërisht të zbatuara, në proces zbatimi, si vijon:**

#### **B. MASA ORGANIZATIVE**

**1.Gjetje nga auditimi** Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve përcjellë me shkresën nr. nr.1445/5 prot., date 22.08.2019, rezultuan të pazbatuara, në proces zbatimi rekomandimet, si vijon:

**Rekomandimi 2: a.** ISSH në Rregulloren për organizimin e detyrave funksionale të Drejtorisë së Përgjithshme të ISSH-së, të rishikojë dhe plotësojë pozicionet e punës për Drejtorinë Qendrore dhe të drejtorive rajonale me kriteret e arsimit dhe të eksperiencës në punë si edhe për emërimin e punonjësve të zbatohen kriteret sipas strukturës së miratuar. KA të miratojë rregulloren për organizimin e detyrave funksionale të Drejtorisë së Përgjithshme të ISSH-së, ku të pasqyrohen ndryshimet në strukturën organizative sipas nevojave të drejtorive përkatëse të institucionit, me qëllim që të bëhet më efektiv zbatimi i detyrave dhe referenca të jetë konform përcaktimeve në Statutin e ISSH dhe ligjin për menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm.

**b.** ISSH të zbatojë dhe të dokumentojë rregullat dhe procedurat e rekrutimit dhe komandimit, të ndërprerjes së marrëdhënieve të punës të punonjësve si dhe të plotësojë vendet e lira të punës në përputhje me strukturën organizative dhe aktivitetin aktual të ISSH-së të përcaktuara në VKA nr. 3/2, datë 26.02.2008 “Për miratimin e Rregullores për personelin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore” për të garantuar transparencë dhe që procesi i menaxhimit dhe vlerësimit të burimeve njerëzore të mbështesë dhe nxisë përmbushjen e objektivave të ISSH-së.

**Rekomandimi 5:** Drejtoria e Financës të marrë masa për aplikimin e një programi të përpunimit elektronik të kontabilitetit si dhe të Pasqyrave Financiare, ku të bëhet hedhja e të dhënave.

**Rekomandimi 7:** Nga ISSH të merren masa që gjatë planifikimit të shpenzimeve për periudhat e ardhshme të planifikojë një zë për shpenzimet që do të nevojiten për të bërë rivlerësimin e aktiveve (tokë, ndërtesë, makineri e pajisje). Rivlerësimet të kryhet në mënyrë të rregullt dhe të mjaftueshme, që të sigurohet se vlera kontabël (neto) e aktivitetit nuk ndryshon materialisht nga ajo që do të përcaktohet nëse do të përdoret vlera e drejtë në datën e bilancit. Vlera e drejtë e tokës dhe ndërtesave duhet të përcaktohet nga evidenca e bazuar në treg nëpërmjet një vlerësimi që ndërmerret nga vlerësues profesionistë të kualifikuar dhe në përfundim të këtij procesi të kryejë pasqyrimin e këtij rivlerësimi në kontabilitet.

**Rekomandimi 14:** Strukturat drejtuese të ISSH, të ndjekin procedurat ligjore në zbatim të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, për asgjësimin/tjetërsimin e mallrave të evidentuara si të papërdorshme, nga komisioni i inventarizimit.

**Rekomandimi 17:** Strukturat drejtuese të ISSH dhe njëkohësisht përgjegjëse për kontributet në ISSH (bujku), në bashkëpunim me strukturat drejtuese të MBZHR të bëjnë të mundur përcaktimin e qartë të termit “fermer” apo i “vetëpunësuar në bujqësi”, shoqëruar këtë ri-përcaktim me ndryshimet ligjore përkatëse, me qëllim rritjen dhe saktësimin e programimit të të ardhurave nga kontributet në sektorin e bujqësisë.

**Rekomandimi 19: a.** Strukturat drejtuese të ISSH, në bashkëpunim me strukturat drejtuese të MFE/Drejtoria e Përgjithshme të Tatimeve, të riorganizojnë dhe mundësojnë evidentimin e subjekteve të biznesit të madh, subjektet fason, dhe subjektet që zhvillojnë veprimtari profesionale, në media etj, të cilat nuk paguajnë në rregull, apo nuk derdhen fare kontribute të sigurimeve shoqërore për të punësuarit e tyre.

**b.** Të ndiqen me prioritet nga Strukturat drejtuese të ISSH, në bashkëpunim me strukturat drejtuese të MFE/Drejtoria e Përgjithshme të Tatimeve mungesa e listë pagesave nga subjektet kontributive me qëllim, për të eliminuar mungesën së periudhave të sigurimit, nëpërmjet analizës së debitorëve për periudhat e mëparshme dhe duke u bërë rast pas rasti rregullimin dhe plotësimin e tyre. E Konkretisht:

- Strukturat drejtuese të ISSH, të ngrejë sipas një programi grupin e punë i cili të këtë mundësinë në bashkëpunim me strukturat drejtuese të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve e hartimit të listë pagesat e munguara të formatit letër të periudhës 2006-2012, në shumën

1,520,423 rreth 94,4% e tyre janë listë/pagesa të munguara të vetë punësuarve (biznes i vogël), dhe 80,910 ose 5,32% janë listë pagesa të munguara të biznesit të madh dhe 4,534 ose 0.3% janë listë pagesa të subjekteve publike, buxhetorë dhe jo buxhetorë dhe të ndiqen dhe mungesat e konstatuara në listë pagesa elektronike ( pas Janarit të vitit 2012) në shumën prej 1,841,174, me qëllim zgjidhjen e mungesave të krijuara dhe sigurimin se proces të monitorohet në vazhdimësi .

c. Institucioni në bashkëpunim me DPT të realizojë mundësinë e dërgimit të dhënave që transmetohen nga DPT) në ISSH si për të ardhurat (kontributet) dhe të listë pagesave të kontributeve sipas llojit të subjekteve (buxhetorë, jo buxhetorë, të vetëpunësuar etj) me qëllim që të realizojë përpunimit të të dhënave nëpërmjet sistemit CMIS (Sistemi elektronik i Menaxhimit të Kontributeve) në lidhje me derdhjen e kontributeve sipas kodit të identifikimit për çdo subjekt (buxhetor, vetëpunësuar, etj..) bazuar në specifikimet teknike, të vendosura në marrëveshjen që DPT duhet të transmetoj drejt ISSH sipas të dhënave referenciale të ndërveprimit (Format Ligjore) veprim i cili do të bëjë të mundur identifikimi nga ISSH sipas të formës ligjore të subjektit të derdhjes së kontributeve dhe evidentimin e detyrimeve kontributeve dhe listë pagesave të munguara.

d. Nga ana e Degëve të Arkivave në DRSSH të përfundojë hartimi i Listës Përfundimtare të subjekteve pagues të kontributeve sipas periudhave përkatëse të listë pagesave ( formati letër), të rezultuara mangët me qëllim ndjekjen e mungesave të krijuara nga Janari i vitit 1994 deri më Dhjetor 2012.

**Rekomandimi 20:** Nga ana e institucionit të ndërmerren iniciativa për publikimin e listave të subjekteve debitorë në DPT dhe ndërhyrje nga ana e MFE me qëllim zgjidhjen e problematikës së krijuar ndër vite dhe minimizimin e evazionit fiskal të krijuar në derdhjen e kontributeve. Gjithashtu nga ana e ISSH të ngrihen grupe pune pranë DRSSH në monitorimin e Drejtorisë së Kontributeve, në lidhje me evidentimin, ndjekjen e detyrimeve debitorëve të vetë punësuarve në bujqësi të cilat rezultojnë në fund të vitit 2018 në vlerë 1,439,181,189 lekë me qëllim arkëtimin e këtyre detyrimeve.

**Rekomandimi 22:** Me qëllim administrimin me efektivitet të fondeve të pensioneve. Institucioni të marrë masa që planifikimi i kontroleve në vijim nga Njësia e Inspektimit të Përfitimeve të kryhen brenda vitit të lidhjes së pensioneve dhe të përfundojë inspektimin për 1,278 të pa çertifikuara dhe kontrollin për 98,353 dosje të pa kontrolluara nga vitet 2016 e në vazhdim.

## 5. AGROKREDIT SHA:

Auditimi në **Shoqërinë Agrokredit Sha** është realizuar sipas Programit të Auditimit Nr.694 Prot, datë 16.07.2020 me objekt “Për Zbatimin e Rekomandimeve të lëna në Auditimet e mëparshme, për auditimet e evaduar në periudhën 01.01.2019-31.12.2019.

Në përfundim të misionit auditues në lidhje me verifikimin e dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga KLSH në Shoqërinë Agrokredit Sha me shkresën e KLSH nr.1446/11 prot, datë 23.12.2019, rezulton në mënyrë të përmbledhur, si më poshtë:

### KONKLUZIONI I AUDITIMIT

Nga auditimi tematik mbështetur në standardet e INTOSAI-t, Manualit të Përputhshmërisë, Manualit të ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve së KLSH-së, i kryer në Shoqërinë Agrokredit Sh.a, rezultoi se për rekomandimet e pranuar niveli i zbatimit te tyre plotësisht, në proces zbatimi ose pjesërisht të zbatuar, është në vlerën 77%.

Në subjektin e audituar, janë rekomanduar gjithsej (32) masa, nga të cilat janë pranuar (24) masa dhe nuk janë pranuar (8) masa. Konstatuam se nga (24) masat e rekomanduara dhe të



pranuara janë zbatuar plotësisht 6 prej tyre ose 26% , pjesërisht 7 masa ose 23%, në proces 6 masa ose 32% dhe nuk janë zbatuar 5 masa ose 23%.

- Masa “Propozime për ndryshime apo përmirësime në legjislacionin në fuqi”: Është rekomanduar 1 masë, e cila është zbatuar por jo në afat.”

- Masa Organizative: Janë rekomanduar 19 masa organizative, nga të cilat janë pranuar 15 masa organizative, 3 masa organizative në proces zbatimi, 4 masa organizative janë realizuar, 4 masa organizative janë realizuar pjesërisht dhe 4 masa organizative nuk janë realizuar, ndërkohë që 4 masa organizative nuk ishin pranuar.

- Masa Shpërblim Dëmi: Janë rekomanduar 6 masa shpërblim dëmi në vlerën 5,688 mijë lekë, nga të cilat janë pranuar 3 masa shpërblim dëmi, 1 masë shpërblim dëmi në proces zbatimi/realizuar pjesërisht në vlerën 909 mijë lekë, 1 masë shpërblim dëmi në vlerën 5 mijë euro dhe 1 masë shpërblim dëmi nuk është realizuar në vlerën 132 mijë lekë, ndërkohë që 3 masa shpërblim dëmi nuk ishin pranuar në vlerën 4,648 mijë lekë .

- Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike. përfshi shpenzime të realizuara në kushte të paligjshmërisë procedurale. Janë rekomanduar 4 masa në vlerën 111, 847 mijë lekë, nga të cilat janë pranuar 3 masa dhe janë në proces zbatimi 3 masa në vlerën 94,327 mijë lekë, ndërkohë që 1 masë nuk është pranuar në vlerën 17,250 mijë lekë.

- Masa Disiplinore. Janë rekomanduar 2 masa disiplinore, 1 masë është rekomanduar Asamblesë së Përgjithshme, përfaqësuar nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë, në cilësinë e Aksionarit të vetëm, dhe nuk është ndërmarrë asnjë veprim dhe 1 masë është rekomanduar Administratorit të shoqërisë dhe nuk është ndërmarrë asnjë veprim. Masat disiplinore për personat përgjegjës nga ana e KLSH janë lënë si rekomandim në diskrecion të subjektit dhe konsiderohen të pranuar për sa kohë nuk është shprehur.

**Për sa më sipër rikërkojmë që Shoqëria AgroKredit Sha të marrë të gjitha masat e nevojshme me qëllim zbatimin e të gjitha rekomandimeve që rezultuan të pa zbatuara, të zbatuara pjesërisht, në proces zbatimi ose të papranuara, si më poshtë:**

## B. MASA ORGANIZATIVE

**Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve përcjellë me shkresën nr.1446/11 prot, datë 23.12.2019, **nuk janë zbatuar, janë në proces zbatimi, janë zbatuar pjesërisht ose janë të papranuara rekomandimet si vijon:**

**Rekomandimi 1.1:** Nga ana organeve drejtuese të shoqërisë, Këshilli Mbikëqyrës, Administratori, të merren masa rishikimin e Politikave të Kreditit dhe Rrezikut dhe miratimin e tyre nga Aksionari, për të shmangur krijimin e situatave favorizuese të klientëve të veçantë dhe për të orientuar aktivitetin e kreditimit në përputhje me misionin e saj. Nga Administratori i shoqërisë të merren masa për arritjen e kushteve të përcaktuara në marrëveshjen e huasë, me qëllim respektimin e raportit të përqindjes së përfituesve fundorë.

**Rekomandimi 2.1:** Nga ana e Administratorit, e Departamentit të Kredisë dhe Menaxhimit të Portofolit, Departamentit të Riskut, Drejtuesve të Degëve dhe Oficerëve të kredisë të merren masa për zbatimin e plotë të Manualit të Administrimit të Kredisë dhe të Politikave të Kreditit dhe Rrezikut, me qëllim shmangien e problematikave në mbledhjen e kredive, pasi gjykojmë që një kredi e dhënë me mangësi dokumentare është një risk i shtuar për arkëtimin e tyre.

**Rekomandimi 3.1:** Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori të marrë masa për të kryer një analizë të detajuar në nivel portofoli dhe dosje kredie individuale me probleme sipas klasifikimeve përkatëse, bazuar në të dhëna financiare të besueshme dhe të dokumentuara, për të evidentuar shkaqet e vërteta dhe problematikat që kanë sjellë shfaqjen e fenomenit. Të

rishikohen manualët përkatëse të kredisë me qëllim që të gjendet hapësira dhe mundësia për ti përmirësuar në drejtimin që të ketë impakt në përmirësimin e procesit të ndjekjes së kredive me probleme dhe deri në arkëtimin e plotë të këtyre kredive.

**Rekomandimi 4.1:** Këshilli Mbikëqyrës të marrë masa të menjëhershme për emërimin e anëtarëve të Komitetit të Auditimit, si një strukturë mbikëqyrëse dhe kontrolluese mbi funksionimin e kontrollit të brendshëm, strukturë që duhet ti japë siguri Këshillit jo vetëm në vendimmarrje, por dhe për veprimtarinë e menaxherëve të shoqërisë.

-Këshilli Mbikëqyrës të marrë masa të menjëhershme për të analizuar në vijimësi treguesit e shoqërisë jo vetëm mbi baza tremujore dhe vjetore, por në afate më të shkurtra, bërë kjo më imediate nga situata financiare e shoqërisë.

-Të marrë në analizë raportet e Auditit të Brendshëm dhe të dalë me vendimmarrjen përkatëse, pasi nga ai janë konstatuar një sërë problematikash dhe shkelje që kanë ndikuar në përkeqësimin e situatës në përgjithësi të shoqërisë dhe në veçanti të situatës financiare.

**Rekomandimi 5.1:** 1-Administratori të marrë masa të menjëhershme për implementimin e një sistemi efikas të kontrollit të brendshëm me të pesë komponentët kryesorë dhe rishikimin e akteve të brendshme rregullative në funksion të kërkesave të ligjit nr.10296, datë 8.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.

2-Administratori, të marrë masa të menjëhershme për analizimin e situatës dhe treguesve të shoqërisë, të kryejë analizimin e kredive jashtë bilancit, dhe të paraqesë në Këshillin Mbikëqyrës raportet periodike, për realizimin e treguesve ekonomikë të shoqërisë, kreditë jashtë bilancit të analizuar minimalisht çdo 6 muaj, por dhe sa herë të bëhet klasifikimi i portofolit të kredive, sikurse kërkohet dhe në manualin e amvisimit të Bankës së Shqipërisë dhe të vetë shoqërisë.

3-Administratori, të marrë masa që në të ardhmen të përgatisë e paraqesë në kohë programet ekonomike të shoqërisë për miratim si nga Këshilli Mbikëqyrës dhe Aksioneri, konform kërkesave të Udhëzimit të MFE nr.15, datë 02.05.2018 “Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital shtetëror”, Kapitulli III “Afatet e hartimit, shqyrtimit dhe miratimit të projekt programeve të zhvillimit”, pika 6.

4-Administratori të marrë masa që në të ardhmen të paraqesë në afat për miratim në Këshillin Mbikëqyrës, raportin mbi rezultatin financiar të vitit si dhe raportin e ekspertëve ligjore, konform kërkesave të Statutit të Shoqërisë, miratuar në vitin 2018 nga Aksioneri, nenet 27 dhe 29.

5-Administratori, të marrë masa për hartimin e programit të punës dhe strategjisë për zbatimin e rekomandimeve, pas shqyrtimit të raporteve të audituesve e mbikëqyrësve të jashtëm apo të konsulentit, nga Këshilli Mbikëqyrës.

**Rekomandimi 6.1:** Nga Shoqëria AGROKREDIT SH.A të merren masa për gjetjen e origjinës së veprimeve, dokumentacionin mbi bazën e të cilit është vepruar, si dhe të bëjë sistemimin në përputhje me rregullat kontabël.

**Rekomandimi 7.1:** Nga shoqëria ish FAF SH.A, tani AGROKREDIT SH.A, Administratori dhe Departamenti i Financës të merren masa për rilogaritjen e saktësimin e fondeve rezervë (provigjonet) dhe të bëhet korrigjimi në zërat e bilancit, e për pasojë të ndryshojë rezultati i ushtrimit 2018 për shumën 93,000,000 lekë.

**Rekomandimi 8.1:** 1-Nga Shoqëria AGROKREDIT SH.A, Administratori, Departamenti i Financës të merren masa që të përgatitet kalimin dhe zbatimin e SNRF 9, e cila është detyrim ligjorë për shoqërinë në hartimin e pasqyrave financiare të vitit 2019.

2-Nga shoqëria AGROKREDIT SH.A, Administratori dhe Departamenti i Financës të merren masat të menjëhershme për korrigjimin e diferencave të konstatuara dhe sistemimet e tyre konform rregullave kontabël.

3-Nga ana e Shoqërisë të merren masa në të ardhmen për hartimin dhe dorëzimin në afat të pasqyrave financiare në organet tatimore dhe në organet drejtuese, së bashku me raportin e

audituesit ligjor, si dhe miratimin e rezultatit, në përputhje të plotë me kërkesat ligjore kontabël dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, me qëllim marrjen e sigurisë për përmbajtjen e tyre.

**Rekomandimi 10.1:** 1-Administratori i AGROKREDIT (ish FAF SH.A) të marrë masa të menjëhershme që të hartojë dhe miratojë Rregullore apo manual për administrimin e asetëve të mbajtura për shitje, për të adresuar qartë detyrat dhe përgjegjësitë e punonjësve të përfshirë në këtë proces.

2-Administratori i AGROKREDIT të marrë masa të menjëhershme që të hartojë dhe miratojë në Këshillin Mbikëqyrës Strategjinë për shitjen e asetëve dhe dhënien me qira, pasi ka një stok të konsiderueshëm të këtyre pronave.

3-Shoqëria FAF SH.A, Administratori të marrë masa të menjëhershme për të kryer inventarizimin e plotë të asetëve për shitje, të ndiqen procedurat ligjore për lirimin e tyre dhe rezultatet të paraqiten në Këshillin Mbikëqyrës.

**Rekomandimi 11.1:** 1-Administratori i AGROKREDIT (ish FAF SH.A) të marrë masa të menjëhershme që me stafin e tij të hartojë dhe miratojë Rregullore apo manual për administrimin e proceseve apo procedurave përmbartimore, për të adresuar qartë detyrat dhe përgjegjësitë e punonjësve të përfshirë në këtë proces.

2-Shoqëria, në të ardhmen të publikojë në adresën e vet, Buletinin e APP dhe në median e shkruar shprehjen e interesit për veprime përmbartimore, duke përfshirë sa më shumë subjekte dhe për ta bërë më transparent procesin.

**Rekomandimi 12.1:** Administratori i AGROKREDIT (ish FAF SH.A) të marrë masa të menjëhershme që:

1-Të marrë në analizë të gjithë veprimtarinë e përmbartuesve apo shoqërive përmbartimore, të bëjë rakordimet me secilën prej tyre, dukë përfshirë dhe subjektet e mëparshme të cilëve u është hequr licenca, si dhe të kërkojë më mënyrë të menjëhershme dhe të dokumentuar përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në kontratat e shërbimeve.

2-Të paraqesë në Këshillin Mbikëqyrës analizën e bërë për veprimtarinë e subjekteve përmbartimore dhe të vetë stafit të shoqërisë.

3-Shoqëria të shmangë fillimin e procedurave përmbartimore për kërkimin e shumave minimale, pasi përbëjnë kosto dhe përfitimi mund të jetë relativisht i ulët ose aspak.

4-Shoqëria, në të ardhmen të publikojë në adresën e vet, Buletinin e APP dhe në median e shkruar shprehjen e interesit për veprime përmbartimore, duke përfshirë sa më shumë subjekte dhe për ta bërë më transparent procesin.

**Rekomandime 13.1:** Nga Departamenti i Burimeve Njerëzore të merren masa për të rregulluar dhe plotësuar me dokumentacion dosjet individuale të punonjësve sipas përcaktimeve të Manualit të Drejtimit të Burimeve Njerëzore.

**Rekomandime 14.1:** Të rishikohen rekrutimet e realizuara në kundërshtim me përcaktimet e Manualit të Drejtimit të Burimeve Njerëzore gjatë vitit 2018, dhe të ndërmerren masa që rekrutimet e reja në të ardhmen të jenë në përputhje me manualin dhe specifikimet e tij në lidhje me rekrutimin e stafit.

**Rekomandimi 15.1:** Të rishikohen rekrutimet e realizuara në kundërshtim me përcaktimet e Manualit të Drejtimit të Burimeve Njerëzore, ku specifikohen përzgjedhja në lidhje me kërkesat e formimit dhe eksperiencën, dhe të ndërmerren masa që rekrutimet e reja në të ardhmen të mos jenë në kundërshtim me manualin dhe specifikimet e tij mbi rekrutimin.

**Rekomandimi 16.1:** Shoqëria AGROKREDIT SH.A, Administratori pas vendimmarrjes së Këshillit Mbikëqyrës me nr.12, datë 20.05.2019 miratuar dhe nga Aksionari me vendimin nr.53, datë 01.07.2019 mbi raportin e Bankës së Shqipërisë, të marrë masa të menjëhershme për zbatimin e plotë të tyre.

## C. MASA SHPËRBLIM DËMI:

**Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve përcjellë me shkresën nr.1446/11 prot, datë 23.12.2019, nuk janë zbatuar, janë në proces zbatimi, janë zbatuar pjesërisht ose janë të papranuara rekomandimet si vijon:

**Rekomandimi 1.1:** Nga Administratori i shoqërisë të marren masa për arkëtimin e vlerës prej 1,161,576 lekë nga OE “H... S...”, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 13070 prot., datë 30.12.2017 me objekt “Blerje Sistem Core Bank MIS”, vlerë kjo e cila përfaqëson penaltetin e pa aplikuar nga ana e Autoritetit Kontraktor ndaj sipërmarrësit të punimeve për vonesa të pa justifikuar në përfundimin e shërbimeve.

**Rekomandimi 2.1:** Nga Administratori i shoqërisë të marren masa të menjëhershme dhe të ndjekë të gjitha procedurat ligjore për arkëtimin e shumës 3,246,096 lekë nga përfituesit (përmbaruesit gjyqësorë privatë, sipas Aneksit nr.3, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**Rekomandimi 4.1:** Nga Administratori i shoqërisë të marren masa të menjëhershme dhe të ndjekë të gjitha procedurat ligjore për arkëtimin e shumës 240,000 lekë nga komisioni i vlerësimit të ofertave z. Xh..., z. R... dhe z. Z... .

**Rekomandimi 5.1:** Nga Administratori i shoqërisë të merren masa për rikuperimin e plotë të dëmit monetar në shumën 308,534.23 lekë, të shkaktuar nga penalteti i marrë nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, si dhe të penaltetit në vlerën 600,000 lekë i përdorur në kundërshtim me kushtet e marrëveshjes së huasë.

**Rekomandimi 6.1:** Nga ana e Administratorit të shoqërisë të merren masa për nxjerrjen e përgjegjësiive për penaltet e marra nga organet tatimore dhe rikuperimin e shumës 131,724 lekë.

#### D. MASA PËR ELEMENIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE. PËRFSHI SHPENZIME TË REALIZUARA NË KUSHTE TË PALIGJSHMËRISË PROCEDURALE.

**Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve përcjellë me shkresën nr.1446/11 prot, datë 23.12.2019, nuk janë zbatuar, janë në proces zbatimi, janë zbatuar pjesërisht ose janë të papranuara rekomandimet si vijon:

**Rekomandimi 1.1:** Nga ana e Administratorit, Departamentit të Kredisë dhe Menaxhimit të Portofolit, Departamentit të Riskut, Drejtuesve të Degëve dhe Oficerëve të kredisë të merren masa për zbatimin e plotë të Manualit të Administrimit të Kredisë dhe të Politikave të Kreditit dhe Rrezikut, për të eliminuar efektet financiare në buxhetin e shoqërisë nga ineficenca e këtyre kredive të dhëna me probleme dhe që përbëjnë risk të shtuar për shoqërinë.

**Rekomandimi 2.1:** Administratori i shoqërisë të marrë masa në të ardhmen për zhvillimin e një procesi transparent dhe konkurrent në procedurat e punësimit, me qëllim rritjen e mundësinë së rekrutimit të punonjëse me aftësi të mira profesionale dhe me eksperiencën e duhur në raport me nevojat që ka institucioni. Administratori i shoqërisë të marrë masa për të rishikuar dhe vlerësuar punën e secilit oficer kredie apo drejtues rajonal, në raport me arritjen e targetit të synuar, me qëllim mirëperformancën e shoqërisë dhe për të eliminuar efektet financiare në buxhetin e shoqërisë nga ineficenca e këtyre punonjësve.

**Rekomandimi 3.1:** Nga ana e Drejtuesve të Shoqërisë të merren masa në të ardhmen për eliminimin e praktikave të tilla në shpërbllimin e punonjësve, para daljes së rezultatit financiar të shoqërisë dhe miratimit të tij nga Aksionari.

**Rekomandimi 4.1:** AGROKREDIT SH.A nëpërmjet strukturave përkatëse, të marrë masa të menjëhershme për eliminimin e praktikave të kualifikimit dhe shpalljes fitues të operatorëve

ekonomik në kushtet e mos plotësimit të kriterëve të miratuara në DST, procedura të cilat deri më tani kanë sjellë pasoja me efekte negative.

## **6. DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE**

Auditimi në **Drejtorinë e Përgjithshme e Doganave** është realizuar sipas Programit të Auditimit Nr.694 Prot, datë 16.07.2020 me objekt “Për Zbatimin e Rekomandimeve të lëna në Auditimet e mëparshme, për auditimet e evaduara në periudhën 01.01.2019-31.12.2019” dhe duke u bazuar në punën e grupit të auditimit që e ushtroi auditimin në Drejtorinë e Përgjithshme e Doganave sipas programit Nr.311/1 Prot., datë 06.04.2020.

Në përfundim të misionit auditues në lidhje me verifikimin e dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga KLSH në Drejtorinë e Përgjithshme e Doganave me shkresën e KLSH nr. 280/11, datë 05.10.2019, rezulton në mënyrë të përmbledhur, si më poshtë:

### **KONKLUZIONI I AUDITIMIT**

Nga auditimi bazuar në punën e grupit të auditimit sipas programit Nr.311/1 Prot., datë 06.04.2020 mbështetur në standardet e INTOSAI-t, Manualit të Përputhshmërisë, Manualit të ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve së KLSH-së, i kryer në Drejtorinë e Përgjithshme e Doganave, rezultoi se për rekomandimet e pranuar niveli i zbatimit të tyre plotësisht, në proces zbatimi ose pjesërisht, është në vlerën 58%.

Në subjektin e audituar, janë rekomanduar gjithsej (17) masa, nga të cilat janë pranuar (12) masa, nuk janë pranuar (2) masa dhe nuk janë shprehur për (3) masa. Konstatuam se nga (12) masat e rekomanduara dhe të pranuar janë zbatuar plotësisht 3 prej tyre ose 25% , pjesërisht 2 masa ose 17%, në proces 2 masa ose 17% dhe nuk janë zbatuar 5 masa ose 42%.

- Masa Organizative, janë lënë 11 rekomandime nga të cilat: janë pranuar 10 rekomandime, nuk është shprehur për 1 rekomandim i cili konsiderohet i pa realizuar. Deri në këtë Raport Përfundimtar të Auditimit janë në proces zbatimi 2 rekomandime, janë realizuar 2 rekomandime, janë pa realizuar 5 rekomandime, janë realizuar pjesërisht 2 rekomandime

- Masa për shpërblim dëmi janë lënë 2 rekomandime në vlerën 919,541 mijë lekë nga të cilat: është pranuar 1 rekomandim i cili është zbatuar në vlerën 78 mijë lekë dhe nuk është pranuar 1 rekomandim në vlerën 919,463 mijë lekë.

- Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike, përfshi shpenzimet të realizuara në kushte të paligjshmërisë procedurale. janë lënë nga 2 rekomandime për të cilat subjekti nuk është shprehur.

- Masa administrative janë lënë nga 1 rekomandim i cili nuk është pranuar

- Masat disiplinore për personat përgjegjës nga ana e KLSH janë lënë si rekomandim në diskrecion të subjektit dhe konsiderohen të pranuar për sa kohë nuk është shprehur.

**Përsa më sipër rikërkojmë që Drejtoria e Përgjithshme e Doganave të marrë të gjitha masat e nevojshme me qëllim zbatimin e të gjitha rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara, të papranuara, të zbatuara pjesërisht, në proces zbatimi, si më poshtë:**

### **B. MASA ORGANIZATIVE**

**Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve përcjellë me shkresën nr. 280/11, datë 05.10.2019, rezultuan të pazbatuara, të papranuara, të zbatuara pjesërisht, në proces zbatimi rekomandimet, si vijon:

**Rekomandimi 1.1:** Strukturat e **Monitorimit, Planifikimit Strategjik dhe Analizës së të Ardhurave** të DPD në bashkëpunim me strukturat përkatëse të MFE, Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Politikave Makro Ekonomike, Çështjeve Fiskale dhe Punësimit, të riorganizojnë dhe mundësojnë **programimin e të ardhurave** në të gjitha fazat edhe me strukturat e DPD, duke shtuar kështu bashkëpunimin për shkëmbimin e të dhënave për subjektet kontribuese që mundësojnë krijimin e të ardhurave dhe për subjektet problematike, të cilat pengojnë krijimin e tyre, në mënyrë që treguesit e programimit të të ardhurave të mos vijnë të gatshëm në DPD, si dhe të programohen drejt e pa rezerva.

**Rekomandimi 2.1:** DPD të marrë të gjitha masat për analizimin e situatës për zbatimin në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, nëpërmjet krijimit të marrëveshjeve të reja me institucionet e tjera, për të bërë të mundur rikuperimin e borxhit doganor në vlerën 27,596,148 mijë lekë.

**Rekomandimi 2.2:** DPD të marrë të gjitha masat duke ngritur një grup pune për verifikimin, analizimin e situatës për veprimet kryera nga zyrat e borxhit pranë degëve doganore jo në përputhje me dispozitat ligjore për procedurat e ndjekura lidhur me rikuperimin e borxhit, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit dhe nxjerrjen e përgjegjësive për të gjitha rastet e mosveprimeve ku subjektet apo agjensitë doganore edhe pse debitorë kanë vijuar aktivitetin doganor në import - eksport.

**Rekomandimi 3.1:** Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, në cilësinë e organit epror dhe Degët Doganore në cilësinë e “autoritetit doganor kompetent” të analizojnë në bashkëpunim të plotë rekomandimet e pa realizuara, duke marrë masa të menjëhershme për analizimin e shkaqeve dhe përgjegjësive konkrete ligjore për moszbatimin e tyre. Nga këto institucione të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme verifikuese dhe administrative ligjore në të gjitha shkallët e gjykimit për kontabilizimin e shumës prej **105,142 mijë lekë**, rekomanduar më parë në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe anekseve përkatëse, përcjellë nga KLSH me shkresën nr. 280/11 prot., datë 05.10.2018 dhe protokolluar në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave me shkresën nr. 22995 prot., datë 08.10.2018.

**Rekomandimi 4.1:** Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, në cilësinë e organit epror dhe strukturat përgjegjëse të marrin të gjitha masat për analizimin e situatës dhe nxjerrjen e përgjegjësive për veprimet kryera jo në përputhje me dispozitat ligjore në lidhje me likuidimin e detyrimeve në tejkallim të afateve të parashkruara, pasi likuidimi me vonesë i tyre përbën risk potencial në rritjen e shpenzimeve buxhetore, si rezultat i lindjes së detyrimeve nga penalitetet për mos likuidim brenda afateve ligjore.

**Rekomandimi 5.1:** Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, të marrë masa të menjëhershme për sistemimin e punonjësve të cilët presin rikthimin në detyrë, në mënyrë që të ndërpritet rritja e shpenzimeve jo efektive. Institucioni duhet gjithashtu të vendosi mbikqyrje të përshtatshme mbi këtë proces për të garantuar funksionimin e kontrolleve të brendshme për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë pa asnjë vonesë subjektive për të mos rënduar buxhetin e shtetit si dhe të marrë masa për hartimin e saktë dhe të përditësuar të databazës së vendimeve gjyqësore në mënyrë të menjëhershme në mënyrë që të shmangen impaktet negative në lidhje me krijimin e detyrimeve të prapambetura

**Rekomandimi 6.1:** Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, të marrë masa të menjëhershme për analizimin e të gjitha vendimet gjyqësore me objekt rikthimin në punë dhe nxjerrjen e përgjegjësive administrative ndaj personave shkaktarë. Në çdo rast, shlyerja e detyrimeve të lidhura me këto vendime të ndjekë radhën e paraqitjes së tyre në MFE, nëpërmjet publikimit të databazës dhe grafikut të shlyerjes edhe në faqen zyrtare të Institucionit

**Rekomandimi 8.1:** Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, të marrë masa të menjëhershme që vendet vakante të plotësohen nga punonjës që përmbushin kriteret sipas pozicionit. Rekrutimi

i punonjësve të jetë sa më i hapur, transparent dhe duke plotësuar të gjitha kriteret e nevojshëm në kualifikim sipas përcaktimeve të bëra në vendet e lira të punës. Nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore të merren të gjitha masat për respektimin e kriterëve. Komiteti i Pranimit të Përhershëm të mbaj relacion dhe evidenca mbi vlerësimin e të gjithë kandidatëve që marrin pjesë në intervistë për shpalljet e vendeve të punës. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave të marr masa për kryerjen e procedurave të konkurimit edhe për punonjësit me kontratë të përkohshme, për të garantuar transparencë në përzgjedhje sipas kriterëve të caktuara

**Rekomandimi 9.1:** Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, të marrë masa të menjëhershme për një hetim administrativ duke analizuar dhe nxjerrë përgjegjësitë për veprimet e kryera jo në përputhje me dispozitat ligjore në lidhje me afatet kohore për transferimet e përkohshme të punonjësve dhe transferimet e shpeshta, në mënyrë që të shmanget risku i transferimeve të detyruara në Drejtori apo struktura të tjera varësie dhe qëndrueshmëria e funksionimit të Institucionit

**Rekomandimi 10.1:** Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, të analizojë dhe të marrë masa të menjëhershme për procedurat e ndjekura nga Komisioni Disiplinor gjatë shqyrtimit të çështjeve për ecurinë disiplinore, në respect të afateve për shyrtingimin e shkeljeve disiplinore, të marrë masa për plotësimin e deklaratave për vlerësimin e paanshmërisë së anëtarëve të KD sipas formateve standarteve si dhe të trajtojë të gjithë rastet me vëmendje maksimale për të shmangur largime të padrejta nga puna të cilat në vazhdim mund të rezultojnë me dëme dhe efekte financiare në Buxhetin e Shtetit

### C. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

**Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve përcjellë me shkresën nr. nr. 280/11, datë 05.10.2019, rezultoi e pazbatuar rekomandimi si vijon:

**Rekomandimi 1.1:** Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, të analizojë dhe të ndjekë të gjitha rrugët ligjore, me qëllim kryerjen e procedurave doganore verifikuese sipas legjislacionit doganor në fuqi dhe zbatimin në rrugë ligjore për vendimmarrjen, kontabilizimin dhe më pas arkëtimin e detyrimeve doganore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kontabilizimit dhe arkëtimin e detyrimeve doganore **për sa më sipër**, referuar nenit: 67, pika 1, shkronja “d/i”; 70, pika 2, shkronja “a”; 70, pika 3; 250, pika 4; 251, pika 2, shkronja “a”; 256, pika 1, shkronja “a” dhe “b”, të Ligjit nr. 102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”.

### D. MASA PËR ELEMENIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE, PËRFSHI SHPENZIMET TË REALIZUARA NË KUSHTE TË PALIGJSHMËRISË PROCEDURALE.

**Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve përcjellë me shkresën nr. 280/11, datë 05.10.2019, rezultuan të pazbatuara rekomandimet si vijojnë:

**Rekomandimi 1.1:** Drejtoria e Përgjithshme e Doganave nëpërmjet strukturave përkatëse, të analizojë dhe të marrë masa të menjëhershme për eliminimin e praktikave të kualifikimit dhe shpalljes fitues të operatorëve ekonomik në kushtet e mos plotësimit të kriterëve të miratuara në DST, procedura të cilat deri më tani kanë sjellë pasoja me efekte negative.

**Rekomandimi 2.1:** DPD të marrë të gjitha masat duke ngritur një grup pune për verifikimin, analizimin e situatës për të gjitha rastet lidhur me veprimet kryera nga zyrat e borxhit pranë degëve doganore jo në përputhje me dispozitat ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit dhe nxjerrjen

e përgjegjësi për të gjitha rastet e mosveprimeve ku subjektet apo agjensitë doganore edhe pse debitorë kanë vijuar aktivitetin doganor në import - eksport.

#### F. MASA ADMINISTRATIVE:

**Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve përcjellë me shkresën nr. nr. 280/11, datë 05.10.2019, **rezultoi i papranuar rekomandimi si vijon:**

**Rekomandimi 1:** Nga auditimi i regjistrimit të faturave në SIFQ u konstatuan fatura të regjistruara përtej afatit 30 ditor, për **55 raste urdhër shpenzimesh, në shumën 67,759,304 lekë** nga Drejtoria e Buxhetit dhe Financës në DPD janë kryer likuidimet në tejkalim të afatit kohor 30 ditorë nga data e faturës origjinale të operatorit ekonomik, në kundërshtim me nenin 52 “Kryerja e shpenzimeve” dhe nenin 54 “Kryerja e pagesave”, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar me nenin 7 “Afati për autoritetet publike” të ligjit nr. 48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”.

Për këtë, KLSH i rekomandon Nëpunësit të Parë Autorizues marrjen e masave në përputhje me kërkesat e nenit 51 “Menaxhimi i Angazhimeve” dhe nenit 71 “Kundërvajtjet administrative” të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, duke analizuar rast pas rasti gjetjet e mësipërme.

### 7. DREJTORIA E PËRGJITSHME E TATIMEVE

Auditimi në **Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve** është realizuar sipas Programit të Auditimit Nr.694 Prot, datë 16.07.2020 me objekt “Për Zbatimin e Rekomandimeve të lëna në Auditimet e mëparshme, për auditimet e evaduara në periudhën 01.01.2019-31.12.2019” dhe duke u bazuar në punën e grupit të auditimit që e ushtroi auditimin në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve sipas programit nr.333/1 Prot., datë 15.04.2020.

Në përfundim të misionit auditues në lidhje me verifikimin e dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga KLSH në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve me shkresën nr.241/19 Prot., datë 09.10.2019, rezulton në mënyrë të përmbledhur, si më poshtë:

#### KONKLUZIONI I AUDITIMIT

Nga auditimi bazuar në punën e grupit të auditimit sipas programit nr.333/1 Prot., datë 15.04.2020 mbështetur në standardet e INTOSAI-t, Manualit të Përputhshmërisë, Manualit të ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve së KLSH-së, i kryer në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, rezultoi se për rekomandimet e pranuar niveli i zbatimit të tyre plotësisht, në proces zbatimi ose pjesërisht, është në vlerën 79%.

Në subjektin e audituar, janë rekomanduar gjithsej (53) masa, nga të cilat janë pranuar (52) masa, nuk është pranuar (1) masë. Konstatuam se nga (52) masat e rekomanduara dhe të pranuar janë zbatuar plotësisht 23 prej tyre ose 44% , pjesërisht 3 masa, ose rreth 7%, në proces 12 masa ose rreth 24% dhe nuk janë zbatuar 12 masa ose rreth 23%

- Masa “Propozime për ndryshime apo përmirësime në legjislacionin në fuqi”: Janë rekomanduar 3 masa, të cilat janë në proces zbatimi.

- Masa Organizative: Janë rekomanduar 33 masa nga të cilat janë pranuar 32 rekomandime dhe nuk është pranuar 1 rekomandim. Nga 32 rekomandimet e pranuar, 9 janë zbatuar plotësisht, 11 janë në proces zbatimi, 10 janë pranuar por nuk janë zbatuar dhe 2 janë pjesërisht të zbatuar.



- Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike. përfshi shpenzime të realizuara në kushte të paligjshmërisë procedurale: Janë rekomanduar 5 masa, nga këto 2 masa janë zbatuar plotësisht, 1 masë në proces zbatimi, 1 masë rezulton e pazbatuar dhe 1 në proces verifikimi.
- Masat disiplinore për personat përgjegjës nga ana e KLSH janë lënë si rekomandim në diskrecion të subjektit dhe konsiderohen të pranuar për sa kohë nuk është shprehur.

**Për sa më sipër rikërkojmë që Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve të marrë të gjitha masat e nevojshme me qëllim zbatimin e të gjitha rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara, të zbatuara pjesërisht, në proces zbatimi ose të pranuar, si më poshtë:**

#### A. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI.

**Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve përcjellë me shkresën Nr.241/19 Prot., datë 09.10.2019, janë në proces zbatimi rekomandimet, si vijon:

**Rekomandimi 1.1:** Në ligjin Nr.152/2013, datë 01.10.2013, “Për Nëpunësin Civil”, neni 66/1, pika 3 “Gjatë kohës së qëndrimit në listë, nëpunësit civil paguhen sipas pozicionit të fundit që kanë pasur në shërbimin civil”, të shtohet pika 3.1 me përmbajtje: *“Nëpunësit civil që gjatë qëndrimit në listë emërohen në një detyrë tjetër në administratën publike, sh.a. me aksioner shtetin apo struktura të financuara nga buxheti i shtetit, pozicionet e të cilave rregullohen nga Kodi i Punës së RSH, do të marrin vetëm diferencën në pagë midis dy pozicioneve, nëse ka. Me lidhjen e marrëdhënies së re të punës, nëpunësi njofton menjëherë institucionin në të cilin rezulton në listë pritje.”*

**Rekomandimi 2.1:** Nisur nga sa më lart, për shkak të hapsirave apo trajtimin e subjekteve me dy standarde, nga administrata tatimore në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë të merren hapa të kujdesshëm në ndryshimet ligjore, për të shmangur “amnistia fiskale” të tilla në të ardhmen.

**Rekomandimi 3.1:** Nga institucioni të merren masa që në bashkëpunim me MFE të propozohen rregullime ligjore në nene që kundërshtojnë njëra tjetrën për sa i përket 2 ligjeve, që kanë të bëjnë me përcaktimin e llojit sipas burimeve të të ardhurave nga kontributet sipas burimeve dhe institucionin që e kryen transferimin e të ardhurave duke ndërhyrë, konkretisht në ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe ligjit nr. 9136, datë 11.09.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore e shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, **për sa i përket:**

- Përcaktimit të **përbërjes së të ardhurave sipas burimit** të krijimit nga kontributet të bëhet në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 66 duke saktësuar përfundimisht përbërjen e të ardhura në kontribute që përveç kamat vonesat përfshirjen dhe llojin e gjobave sipas burimit të krijimit.

- **Dhe procedurës së transferimit të këtyre kontributeve** në ISH dhe FSKSH, duke përcaktuar institucionin përkatës. Aktualisht kjo procedurë kryet në fakt nga MFE në zbatim të ligjit nr. 9936, datë 2.0.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, neni 39, paragrafi 5 dhe të UMF nr. 02, datë 0.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” pika V.1 “Buxheti i sigurimeve shoqërore”, pika 226, **duke rregulluar kështu** nenin 3 dhe nenin 4 të ligjit nr. 9136, datë 11.09.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore e shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar

## B. MASA ORGANIZATIVE

**1.Gjetje nga auditimi** Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve përcjellë me shkresën Nr.241/19 Prot., datë 09.10.2019, nuk janë zbatuar, janë në proces zbatimi, janë zbatuar pjesërisht, nuk janë pranuar rekomandimet, si vijon:

**Rekomandimi 3.1:** DPT në bashkëpunim me AKBN, MFE dhe me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë të riverifikojë, me grup të përbashkët pune, veprimtarinë e subjektit koncensionar **A A E SHA**, por edhe të koncensionarëve të tjerë që veprojnë në fushën energjetike, për saktësimin e vlerës së punimeve faktike të realizuara në vepra deri në llogaritje e tatimit mbi vlerën e shtuar, e për rrjedhojë ligjshmërinë e shumës së TVSH-së së rimbursuar shoqërisë në vlerën 4.072.442 mijë lekë, tashmë edhe në funksion të lejes së ndërtimit.

**Rekomandimi 5.1:** Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtoria e Analizës dhe Kontabilitetit në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit e Degën e Thesarit Tiranë të marrë masa të menjëhershme për evidentimin e saktë të gjendjes së llogarisë 4665 “Të ardhura për tu sistemuar në periudhat e mëvonshme”, e cila në pasqyrat financiare të vitit 2018 rezulton në shumën 66,576,166,799 lekë, në përputhje me kërkesat e Udhëzimit standart për zbatimin e buxhetit nr.2, datë 06.02.2012, me ndryshime dhe Udhëzimin nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të qeverisjes së përgjithshme”.

**Rekomandimi 6.1:** DPT të kryej një kontroll të plotë mbi 50 tatimpaguesit buxhetorë në DRT Tiranë, duke marrë të gjitha masat administrative dhe ligjore konform legjislacionit në fuqi, për mbledhjen e borxhit tatimor, sipas nenit 88 të ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

**Rekomandimi 7.1:** DMF të Borxhit të hartojë një strategji konkrete efektive të reflektuar në programin vjetor të punës për marrjen e masave konkrete për rikuperimin e borxhit, për monitorimin dhe mbikqyrjen e masave shtrënguese për mbledhjen e detyrimeve për DRT, pavarësisht se mbikqyrja dhe ndjekja e dosjes së tatimpaguesit realizohet nga inspektorët e kontrollit pranë DRT-ve përkatëse, duke rritur kështu dhe ushtruar funksionin e saj mbikqyrës më me efikasitet, me politika që do të bëjnë më transparent procesin e masave shtrënguese të mbledhjes me forcë të borxhit në bashkëpunim me Drejtorinë e Kontrollit Tatimor dhe atë Hetimor në mënyrë që të rritet arkëtimi i borxhit, duke përmbushur detyrimet e saj ligjore dhe administrative.

**Rekomandimi 8.1:** Nga ana e DPT të merren masa për përfshirjen e të gjitha detyrimeve tatimore në të njëjtën bazë të dhënash në sistemin C@TS në mënyrë që të bëhet ndjekja në kohë reale e tyre. Ekzistenca e detyrimeve tatimore jashtë sistemit aktual krijon kushte për keqpërdorime të pa analizuara në kohën e duhur dhe të merren masa që të ndiqet arkëtimi sipas dispozitave ligjore në fuqi për detyrimet e akcizës të mbajtura jashtë sistemit C@TS në shumën prej 2,331,447,296 lekë, sipas të dhënave nga kontabiliteti i DNJTM, që i përket të pa transferuara në DPD.

**Rekomandimi 11.1:** Drejtoria e Buxhetit dhe Financës të marrë masa të menjëhershme në vijimësi për respektimin me rigorozitet të parimit FIFO në shlyerjen e detyrimeve ndaj ish punonjësve të larguar nga puna.

**Rekomandimi 12.1:** Komisioni i Posaçëm të marrë masa të menjëhershme për trajtimin e 126 praktikave gjyqësore të pa trajtuara ende.

**Rekomandimi 13:** Departamenti i Administratës Publike të bëjë në mënyrë të menjëhershme verifikimin e pozicioneve të identifikuar në tabelë dhe identifikimin e pozicioneve të

rregulluara me status nënpunësi civil, me qëllim ndërprerjen e menjëhershme të pagesës së shpenzimeve gjyqësore në DPT, si dhe marrjen e masave disiplinore për këta nënpunës.

**Rekomandimi 14:** Departamenti i Administratës Publike të marr masa të menjëhershme për nxjerrjen e akteve të emërimit apo të refuzimit për propozimet e bëra brenda kategorive, nga Komisioni i Posacëm.

**Rekomandimi 15.1:** Strukturat Përkatëse të marrin masat për ndërprerjen e delegimeve për pozicionet vakante dhe plotësimin e vendeve vakante me vendime emërimi.

**Rekomandimi 16.1:** Strukturat përkatëse të marrin masat:

Argumentimin dhe mbështetjen në evidenca të kërkesave në planifikim për punonjës shërbimi, kërkesa të cilat shndërrohen në kërkesa për fonde buxhetore.

Mirë përcaktimin e punës që bën secili punonjës si dhe përshkrimin specifik të punës që kryhet në secilin pozicion.

Rregullimin dhe ndjekjen e një procedure rekrutimi dhe punësimi, që përfshin shpalljen në institucione për pozicionet përkatëse, kriteret dhe afatet e aplikimit nga të interesuarit, procesin e kualifikimit, përzgjedhjes dhe shpalljen e fituesve.

**Rekomandimi 17.1:** Strukturat përkatëse të marrin masat për emërimin e konkurrentëve të shpallur fitues në pozicione pune për të cilat ata kanë aplikuar, janë kualifikuar, dhe për të cilat plotësojnë kriteret në formim profesional dhe vjetërsi në profesion.

**Rekomandimi 18.1:** Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve në bashkëpunim me Drejtorinë e Kontrollit Tatimor në DPT dhe Drejtorinë Ligjore të marrë masa për hartimin e një Rregullore në përputhje me Rregulloren e Brendshme të Administratës Tatimore Qëndrore, në të cilin përcaktohen hapat dhe procedurat që duhet të ndjekin Inspektorët e Kontrollit në DKT për kryerjen e procesit të kontrollit në subjekt, përgatitjen e raportit të kontrollit, përgatitjen e raportit përfundimtar të kontrollit dhe dokumentet standarde të nevojshme, qasjet, metodat dhe teknikat që ata duhet dhe mund të përdorin në ushtrimin e veprimtarisë kontrolluese të zbatimit të legjislacionit tatimor.

**Rekomandimi 18.2:** Drejtoria e Kontrollit Tatimor në DPT të përcaktojë prioritetet që duhen ndjekur në realizimin e detyrave dhe objektivave të DPT, duke miratuar plane mujore të Drejtorisë së Kontrollit Tatimor me detyra për të 3 sektorët përbërës të saj ku gjejnë pasqyrim të gjitha objektivat dhe prioritetet e parashikuara në dokumentet bazë të Strategjisë së Përmbushjes.

**Rekomandimi 18.3:** Drejtoria e Kontrollit Tatimor në DPT, në bashkëpunim me Drejtorinë e Menaxhimit të Riskut, e cila menaxhon dhe ndjek zbatimin e planeve të kontrolleve mujore të dërguara në DRT-të, rezultatet e kontrolleve nëpërmjet evidencave mujore brenda datës 10 të çdo muaji, analizon e përpunon vlerësimet e mbledhura mbi analizën e riskut për tatimpaguesit e kontrolluar nga të gjithë drejtoritë tatimore rajonale si dhe mban evidencë të detajuar në lidhje me numrin dhe llojin e kontrolleve për çdo DRT, të analizojnë rezultatet dhe progresin e bërë kundrejt planit dhe kundrejt faktorëve të riskut mbi të cilët subjekti është përzgjedhur për kontroll.

**Rekomandimi 18.4:** Drejtoria e Kontrollit Tatimor në DPT të përzgjedhë në bazë të një analize risku, me elemente të përcaktuara risku, kontrolle në vend për çdo lloj aktiviteti ekonomik për të siguruar rishikim të cilësisë dhe standardizimit të tyre nga Sektori i Cilësisë Standardizimit strukturë e kësaj Drejtorie. DPT, të marrë masa për adresimin e ndjekjes së evidencave nga struktura përkatëse në DMR, me qëllim që Sektori i Cilësisë së Standardizimit të kryejë funksionin e tij në përputhje dhe me planin e DKT.

**Rekomandimi 19.1:** Drejtoria e Hetimit Tatimor të fokusojë drejtimet kryesore të punës, në ushtrimin e kompetencave ligjore në hartimin e planeve operacional bazuar në plan të programuar dhe të përcaktuar të kontrollit dhe rikontrollit të vazhdueshëm të punës mbi të cilat lëshohen urdhëra- shërbimi ditorë ose javore për lëvizjen e inspektoreve të Sektorit të Zbatimit nga një rreth/zonë/minizonë/ rrugë në tjetrën, për identifikimin e subjekteve, të cilët ushtrojnë

veprimtari pa regjistruar në QKB, që nuk deklarojnë punonjësit në organin tatimor, që nuk instalojnë dhe mirëmbajnë pajisjet fiskale ose sistemet e monitorimit, që nuk lëshojnë kupon tatimor.

**Rekomandimi 19.2:** Drejtoria e Hetimit Tatimor të rrisë bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale Tatimore në mbështetje të Drejtorisë së Mbledhjes me Forcë duke hartuar një plan konkret dhe në vijimësi për të mbështetur Drejtorinë e Mbledhjes së Borxhit për zbatimin e masave shtrënguese për ekzekutimin e masave shtrënguese për ekzekutimin e urdhër Sekuestrove, sekuestrimin e aseteve dhe pasurive të tjera të luajtshme dhe konfiskimin e xhiros ditore, të subjekteve debitorë në organin tatimor.

**Rekomandimi 20.1:** Strukturat drejtuese të MFE/Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Politikave Makro Ekonomike, Çështjeve Fiskale dhe Punësimit në bashkëpunim me strukturat drejtuese të DPT, të marrin masa që:

- Të riorganizojnë dhe mundësojnë programimin e të ardhurave të mbledhura nga DPT dhe në të gjitha fazat edhe nga strukturat e DPT, duke shtuar bashkëpunimin me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve në mënyrë që treguesit e programimit të të ardhurave të mos vijnë të gatshme në DPT, por të programohen referuar një analize të drejtë e pa rezerva nga të dyja strukturat.

**Rekomandimi 21.1:** Rekomandimi: Në protokollin e marrëveshjes së komunikimit, të lidhur ndërmjet ISSH dhe DPT me nr.11622, datë 19.05.2017, të shtohet dhe pronësia e tatimpaguesve (shtetërorë, private, ehuaj, e përbashkët etj), përveç formës ligjore, në mënyrë që kombinimi i të dyja formave të bëhet e mundur indentifikimi i subjekteve tatimpaguesve buxhetorë, jobuxhetorë dhe private.

**Rekomandimi 22.1:** Nga DPT të merren masat që gjatë planifikimit të shpenzimeve për periudhat e ardhshme të planifikojë një zë për shpenzimet që do të nevojiten për të bërë rivlerësimin e aktiveve (Tokë, ndërtesë, makineri e pajisje). Rivlerësimet të kryhen në mënyrë të rregullt dhe të mjaftueshme, që të sigurohet se vlera kontabël (neto) e aktivitetit nuk ndryshon materialisht nga ajo që do të përcaktohet nëse do të përdorej vlera e drejtë në datën e bilancit. Vlera e drejtë e tokës dhe e ndërtesave duhet të përcaktohet nga evidenca e bazuar në treg nëpërmjet një vlerësimi që ndërmerret nga vlerësues profesionistë të kualifikuar dhe në përfundim të këtij procesi të kryejë pasqyrimin e këtij rivlerësimi në kontabilitet.

**Rekomandimi 23.1:** Nga strukturat përgjegjëse të DPT të merren masat për planifikimin e një buxheti sa më real, me qëllim që për të gjitha shpenzimet e programuara, të mos krijohen diferenca të dukshme midis parashikimit dhe realizimit të buxhetit.

**Rekomandimi.24.1:** Nëpunësi Autorizues për zbatimin e kontratave të ngrejë menjëherë komisionin e marrjes në dorëzim të mallrave e shërbimeve. Drejtoria e Buxhetit dhe Financës dhe Sektori i Prokurimeve, të marrin masa që në të ardhmen, dokumentacioni justifikues i zbatimit të kontratave për mallra e shërbimeve të jetë konform kërkesave të dispozitave ligjore e nënligjore.

**Rekomandimi 25.1:** Strukturat përgjegjëse të analizojnë, nxjerrin përgjegjësitë dhe të marrin masat e menjëhershme për likuidimin brenda afatit ligjor të detyrimeve, pasi likuidimi me vonesë i tyre përbën risk potencial në rritjen e shpenzimeve buxhetore, si rezultat i lindjes së detyrimeve nga penalitetet për mos likuidim brenda afateve ligjore.

**Rekomandimi 27.1:** Nga strukturat përgjegjëse të DPT-së të kryhet një proces i kujdesshëm gjatë inventarizimit, me qëllim rritjen e cilësisë së informacionit që gjenerohet nga pasqyrat financiare krahasuar me gjendjen fizike, si edhe shmangien e risqeve potenciale që lidhen me menaxhimin e vlerave materiale, me qëllim parandalim e shpërdorimit dhe humbjet e tyre.

**Rekomandimi 29.1:** Nëpunësit Autorizues dhe Zbatues, të marrë masat, që procesi i inventarizimit deri në asgjësimin/tjetërsimin e materialeve jashtë përdorimit të kryhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

**Rekomandimi 30.2:** Drejtoria e Buxhetit dhe Financës të vijojë kontabilizimin mbi bazën e parimit të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara dhe të regjistrojë në kontabilitet shumën 323,562,049 lekë, e cila pasqyron vlerën totale të detyrimit sipas Vendimeve Gjyqësore të formës së prerë të pa regjistruar.

**Rekomandimi 30.3:** Drejtoria e Financës të detajojë në mënyrë analitike sipas natyrës së të ardhurave të trashëguara shuma 8,343,796 lekë, të llogarisë pasive 466 ‘Kreditorë për mjete në ruajtje’.

**Rekomandimi 31.1:** Drejtoria e Financës të kryej në çdo rast regjistrimin kontabël të vlerës së amortizimit sipas normave të legjislacionit në fuqi.

**Rekomandimi 32.1** Të kryhet një proces i kujdeshëm dhe i saktë gjatë llogaritjes së pagave dhe raporteve mjekësore, me qëllim rritjen e cilësisë së informacionit që gjenerohet për shmgangien e risqeve që lidhen me menaxhimin dhe administrimit të drejtë të fondeve buxhetore për paga e shpërblime.

**Rekomandimi 33.1** Të analizohen rekomandimet e pa realizuara, duke marrë masa të menjëhershme për nxjerrjen e shkaqeve dhe përgjegjsive konkrete ligjore për moszbatimin e tyre, si dhe ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ligjore për zbatimin e plotë të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm sipas Raportit Përfundimtar të Auditimit, të përcjellë nga KLSH me shkresën nr.280/12 Prot., datë 21.11.2018

#### D. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE, PËRFSHIRË SHPENZIME TË REALIZUARA NË KUSHTE TË PALIGJSHMËRISË PROCEDURIALE

**Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve përcjellë me shkresën Nr.241/19 Prot., datë 09.10.2019, **nuk janë zbatuar, janë në proces zbatimi rekomandimet, si vijon:**

**Rekomandimi 1.1** DPT në bashkëpunim me DTM, të kryej kontroll të plotë mbi këta tatimpagues si dhe të marrë të gjitha masat administrative dhe ligjore konform legjislacionit në fuqi për mbledhjen e borxhit tatimor, si subjekte nga 10 tatimpaguesit në Top-listën e tatimpagueve me borxhin tatimor më të lartë në zbatim të kërkesave të nenit 88 të ligjit 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

- Të merren masa që administrata tatimore e DTM bazuar në të dhënat e pasqyrave financiare, duhet të kryejë verifikimin e nevojshëm në pasqyrat financiare të depozituara nga subjekti tatimpagues “B P A” LTD me numër Nipti K.....L në mënyrë që të përcaktojë diferencat e rrjedhuara në zbatim të nenit 29 i ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar dhe si rrjedhojë të ndiqet mundësia e arkëtimit të detyrimeve.
- DPT nëpërmjet strukturave të saj si Drejtoria e Kontrollit Tatimor të kryej një kontroll të plotë mbi subjektin “S E L”, Dega në Shqipëri me nipt J.....H, duke marrë të gjitha masat administrative dhe ligjore konform legjislacionit në fuqi për mbledhjen e borxhit tatimor, referuar nenit 88 të ligjit nr.9920, datë 19.05.2018 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Nga DPT për subjektin “B -2” me numër nipti K.....0, nëpërmjet Drejtorisë Rajonale Tatimore Durrës, në zbatim të ligjit nr.9920, datë 19.05.2018 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të kërkojë kontroll tatimor duke bërë verifikimin dhe konfiskimin jo me pak se 50% të qarkullimit ditor, të realizuar me qëllim arkëtimit të detyrimit.

**Rekomandimi 4.1:** Strukturat Drejtuese të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve 37 të marrin

të gjitha masat e nevojshme për nxjerrjen e përgjegjësisë, dhe marrjen e masave ndaj personave përgjegjës, me qëllim eliminimin dhe parandalimin e problematikave të shumta të projekteve të Teknologjisë së Informacionit që nga planifikimi, identifikimi dhe propozimi i projekteve, vlerësimi, miratimi, detajimi, rishpërndarja e fondeve, inicimi i procedurave të prokurimit të pa mbështetura në fonde buxhetore, lidhja e kontratave në zbatim të parashikimeve të Kodit Civil RSH dhe zbatimi i kontratave në përputhje me të gjitha parashikimet ligjore.

**Rekomandimi 5.1:** Marrja e masave të menjëhershme për eliminim e praktikave të kualifikimit dhe shpalljes fitues të operatorëve ekonomik në kushtet e mos plotësimit të kriterëve të miratuara në DST, procedura të cilat deri më tani kanë sjellë efekte negative.

## **8. MFE: DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BUXHETIT DHE BORXHIT**

Auditimi në **Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit dhe Borxhit** është realizuar sipas Programit të Auditimit Nr.694 Prot, datë 16.07.2020 me objekt: “Për Zbatimin e Rekomandimeve të lëna në Auditimet e mëparshme, për auditimet e evaduara në periudhën 01.01.2019-31.12.2019” dhe duke u bazuar në punën e grupit të auditimit që ushtroi auditimin në Drejtorinë e Përgjithshme të Borxhit Publik dhe Bashkërendimit sipas programit nr.344/1 Prot., datë 15.04.2020 me objekt “Auditim mbi Përputhshmërinë” dhe auditimin në Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit sipas programit nr.349/1 Prot., datë 12.05.2020 me objekt “Auditim mbi Përputhshmërinë”

Në përfundim të misionit auditues në lidhje me verifikimin e dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga KLSH në Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit dhe Borxhit me shkresën prot 1447/12 nr, datë 02.10.2019.

### **KONKLUZIONI I AUDITIMIT**

Nga auditimi i bazuar në punën e grupit të auditimit që ushtroi auditimin në Drejtorinë e Përgjithshme të Borxhit Publik dhe Bashkërendimit sipas programit nr.344/1 Prot., datë 15.04.2020 me objekt “Auditim mbi Përputhshmërinë” dhe auditimin në Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit sipas programit nr.349/1 Prot., datë 12.05.2020 me objekt “Auditim mbi Përputhshmërinë” mbështetur në standardet e INTOSAI-t, Manualit të Përputhshmërisë, Manualit të ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve së KLSH-së, i kryer në Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit dhe Borxhit, rezultoi se për rekomandimet e pranuar niveli i zbatimit të tyre plotësisht, në proces zbatimi ose pjesërisht, është në nivelin 58%.

Në subjektin e audituar, janë rekomanduar gjithsej (31) masa, nga të cilat janë pranuar (23) masa dhe nuk janë pranuar (8) masa. Konstatuam se nga (23) masat e rekomanduara dhe të pranuar janë zbatuar plotësisht 1 prej tyre ose rreth 4% , pjesërisht 0 masa, në proces 11 masa ose rreth 46 % dhe nuk janë zbatuar 10 masa ose 42%.

- Nga 15 masa organizative të rekomanduara, janë pranuar 9 masa organizative dhe nuk janë pranuar 6 masa. Nga 9 masat e pranuar, rezultojnë 0 masa të zbatuara, 4 masa në proces zbatimi dhe 5 masa të pazbatuara.

- Nga 14 për eliminimin e efekteve negative në fondet publike në vlerën 14,581,771 mijë lekë, janë pranuar 12 masa dhe nuk janë pranuar 2 masa. Nga 12 masat e pranuar në vlerën 14,187,344 mijë lekë janë në proces 7 rekomandime në vlerën 5,819,344 mijë lekë, janë pa zbatuar 5 rekomandime në vlerën 8,368,000 mijë lekë.

- Masat administrative dhe disiplinore për personat përgjegjës nga ana e KLSH janë lënë si rekomandim në diskrecion të subjektit dhe konsiderohen të pranuar për sa kohë nuk është shprehur.

**Për sa më sipër rikërkojmë që Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit dhe e Borxhit në Ministrinë e Financave të marrë të gjitha masat e nevojshme me qëllim zbatimin e të gjitha rekomandimeve që rezultuan të pa zbatuara, të zbatuara pjesërisht, në proces zbatimi ose të papranuara, si më poshtë:**

## **B. MASA ORGANIZATIVE**

**1.Gjetje nga auditimi** Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve përcjellë me shkresën nr. 919/7, datë 06.01.2020, rezultuan të pazbatuara, të papranuara, të zbatuara pjesërisht, në proces zbatimi rekomandimet, si vijon:

**Rekomandimi 1:** Nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në çdo rast të emetimit të instrumentave financiarë të respektohen limitet e huamarrjes dhe të projektohen treguesit fiskalë nëpërmjet vendosjes së kufijve sasiore në lidhje me këto instrumenta të emetuar. Të gjitha huatë e reja të jenë pjesë e planifikimit në seksionin nën deficit si burim financimi dhe në të njëjtën kohë pjesë e tabelës së treguesve fiskalë të konsoliduar.

**Rekomandimi 2:** Ministria e Financave dhe Ekonomisë e cila është e ngarkuar për kryerjen e procedurave të përzgjedhjes, në rastet e emetimit të instrumentave financiare në tregjet e huaja, në çdo rast të përfshijë në kërkesën për propozim që u drejtohet palëve të interesuara, kriteret e përgjithshme dhe të veçanta mbi të cilat do të kryhet vlerësimi si dhe pikëzimin përkatës të tyre, me qëllim rritjen e aksesit në informacion dhe zhvillimin e një gare me kushte të barabarta për të gjithë ofertuesit potencialë. Të shmanget praktika e përcaktimit të nën kriterëve që nuk janë në përputhje me VKM dhe që nuk janë bërë publike në kërkesë për propozim “RFP”.

**Rekomandimi 4:** Nga ana e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, të merren masa për:

**a.** Hartimin e një metodologjie për vlerësimin dhe rivlerësimin e aseteve të trupëzuara, duke përcaktuar një plan masash për të vënë në jetë Strategjinë e Menaxhimit të Financave Publike 2020-2022, të cilat duhet të shërbejnë si bazë për përgatitjen e inventarit të aseteve si për qeverisjen e përgjithshme dhe për qeverisjen vendore, ashtu edhe për përgatitjen e saktë të pasqyrave të konsoliduara financiare të qeverisë;

**b.** Rregullimin e sistemimeve financiare për periudhat e mbyllura më parë, duke bërë të mundur që vlerat e periudhës së mëparshme të pasqyrave të gjeneruara nga SIFQ, të mos ndryshojnë në varësi të kohës së printimit, duke i bërë këto pasqyra të besueshme dhe në përputhje me rregullat bazë të kontabilitetit;

**c.** Përgatitjen dhe dorëzimin e pasqyrave financiare në kohë dhe sipas përcaktimeve ligjore, nga të gjitha institucionet e qeverisjes së përgjithshme, por edhe nga institucionet ekstra buxhetore, duke aplikuar sanksione ndëshkuese për shkeljet administrative për persona e institucione që shkelin përcaktimet ligjore.

**Rekomandimi 5:** Strukturat drejtuese të MFE, të bëjnë të mundur **rishikimin e udhëzimin e Ministrit të Financave nr.7, datë 18.01.2008** “Për përfaqësimin dhe evidentimin e vendimeve gjyqësore që ekzekutohen nga Ministria e Financave”, sepse është shumë i vjetër në kohë, e kur kjo ministri kishte strukturë organike tjetër dhe të tjera funksione dhe ku shumë detyrime për tu plotësuar relatohen në strukturat e gabuara, në mënyrë që të mundësohet kryerja e procedurave të nevojshme për ekzekutimin vullnetar dhe të mos rëndohen shpenzimet buxhetore me shpenzime përmbarimore.

**Rekomandimi 6:** Të gjitha projektet e financuara nga Fondi i Zhvillimit të Rajoneve, nëpërmjet të gjitha programeve buxhetore sipas Ministrive të Linjës, të raportohen në Tabelën Fiskale të diferencuara nga projektet që nuk kanë burim financimi Fondin e Zhvillimit të Rajoneve, nëpërmjet vendosjes së një kodi identifikues në SIFQ.

**Rekomandimi 7:** Ministria e Financave dhe Ekonomisë të marrë masa për raportimin e pagesave të kryera për detyrimet e prapambetura, si zë më vete në Tabelën e Treguesve Fiskal

të Konsoliduar, me qëllim që të ofrohet një paraqitje e drejtë e vlerës së investimeve kapitale të kryera gjatë vitit buxhetor.

**Rekomandimi 8:** Ministria e Financave dhe Ekonomisë gjatë hartimit të projekt-ligjit për Aktet Normative duhet të identifikojë dhe të reflektojë të gjitha rishpërndarjet e fondeve të ndodhura gjatë vitit, midis programeve të ndryshëm buxhetorë, me qëllimi paraqitjen e plotë, të drejtë dhe të saktë të vlerave përfundimtareve të programeve buxhetore në Tabelën e Treguesve Fiskal të Konsoliduar.

**Rekomandimi 9:** Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë, me qëllimi rivendosjen e drejtësisë dhe dinjitetit shoqëror të kësaj shoqërie, të kërkojë shtimin e fondeve për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë, duke mundësuar shlyerjen e detyrimit të njohur nga shteti Shqiptar.

**Rekomandimi 10:**

**a.** Drejtoria e Pagesave dhe Dëmshpërblimeve të marrë masat për kryerjen e rakordimeve mujore dhe progresive me bankat e nivelit të dytë, Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe me Thesarin lidhur me dëmshpërblimet e akorduara për ish të përndjekurit politikë me qëllimi sigurimin e një paraqitje të plotë dhe transparente.

**b.** Drejtoria e Pagesave dhe Dëmshpërblimeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, në bashkëpunim me Nëpunësin e parë autorizues, të iniciojë akt nënligjor për transferimin e programit buxhetor për pagesat e ish të dënuarve politik nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

**Rekomandimi 11:** Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të korrigojë shumat e raportuara në zërin e shpenzimeve kapitale me financim të huaj si pasojë e raportimit jo në periudhën e duhur të projekteve me financim të huaj në formën e huas dhe grandit si dhe të marrë masa administrative ndaj personave përgjegjës për raportimin e projekteve me vonesë.

**Rekomandimi 12:** Drejtoria e Buxhetit në bashkëpunim me Drejtorinë e Thesarit dhe Borxhit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, të marrin masat për raportimin e saktë të planit të shpenzimeve me financim të huaj dhe realizimin e pagesave në mënyrë të detajuar duke ndarë shpenzimet operative në shërbim të kontratës nga ato kapitale, në mënyrë që të shmangët rritja artificiale e investimeve kapitale me financim të huaj në Pasqyrën e Treguesve Fiskal të Konsoliduar.

**Rekomandimi 13:** Ministria e Financave dhe Ekonomisë të marr masa që të gjitha disbursimet dhe shpenzimet të cilat lidhen me projektet me financim të huaj, të regjistrohen në SIQF me kursin e këmbimit të Bankës së Shqipërisë të ditës kur ndodh transaksioni, me qëllimi paraqitjen e vlerës së saktë të investimeve kapitale me financim të huaj në Tabelën e Treguesve Fiskla të Konsoliduar.

**Rekomandimi 14:** Ministria e Financave dhe Ekonomisë, të marrë të gjitha masat e nevojshme:

-Për **shpërndarjen e njëtrajtshme të shpenzimeve buxhetore gjatë vitit**, me qëllim shmangien e shpenzimeve inefficente dhe reduktimin e luhatjeve të treguesve ekonomikë dhe financiarë.

-Për regjistrimin e saktë të planit të Financimit të Deficitit në SIFQ, në zbatim të ligjit të buxhetit dhe akteve normative në zbatim të tij, me qëllim shmangien e mënyrës së financimit të tij.

**D. MASA PËR ELEMENIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE, PËRFSHI SHPENZIME TË REALIZUARA NË KUSHTE TË PALIGJSHMËRISË PROCEDURIALE.**



**Gjetje nga auditimi** Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve përcjellë me shkresën nr. 919/7, datë 06.01.2020, rezultuan të pazbatuara, të papranuara, të zbatuara pjesërisht, në proces zbatimi rekomandimet, si vijon:

### **Rekomandimi 1:**

**1.1** Ministria e Financave dhe Ekonomisë si përgjegjëse për hartimin e dokumentit të Planit Buxhetor Afatmesëm (PBA), duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme për:

a) Fuqizimin e dokumentit të Planit Buxhetor Afatmesëm me qëllim minimizimin e riskut të rishikimit të buxheteve në fazën e zbatimit të tij (ulje apo ngritje) me qëllim minimizimin e vonesave që krijohen në financimin dhe ecurinë e punimeve si dhe krijimin e detyrimeve të prapambetura.

b) Fuqizimi i rolit të auditit të brendshëm në drejtim të hartimit të dokumentit të Planit Buxhetor Afatmesëm nga ana e organeve buxhetore.

c) Vendorsjen e sanksioneve për moszbatimin e rregullave apo zbatimin jo korrekt të tyre në lidhje me hartimin e dokumentit të Planit Buxhetor Afatmesëm.

d) Vazhdimin e trajnime në shkallë të gjerë për të gjitha ministritë e linjës dhe institucionet e tjera buxhetore në lidhje me hartimin e dokumentit të PBA-së, në mënyrë që ky dokument të sjellë rezultatet e dëshiruara brenda burimeve të qëndrueshme financiare për tre vitet e ardhshme.

**1.2** Ministria e Financave dhe Ekonomisë, të marrë masat e nevojshme për propozim për përmirësimin e legjisllacionit në lidhje me: Përmirësimin e shtojcës nr. 02, “Procedurat e Menaxhimit të Investimeve”, të VKM 185, datë 29.03.2018 “Për procedurat e Menaxhimit të Investimeve Publike”, me qëllim, miratimin e Projekt Propozimeve nga Titullari i institucionit si dhe më pas përfshirjen e saj si pjesë e udhëzimit standard “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”.

**Rekomandimi 2:** Ministria e Financave dhe Ekonomisë, duhet të marrë të gjithë masat e nevojshme me qëllim:

**a.** Respektimin e Ligjit Organik të Buxhetit dhe Ligjin për Vetëqeverisjen Vendore në drejtim të detajimit të shpenzimeve të cilat do të kryhen nga transferata e pakushtëzuar e papërdorur dhe pjesa e të ardhurave të veta të papërdorura të trashëguara.

**b.** Marrjen e një informacioni më të detajuar nga njësitë vendore në lidhje me Detyrimet e Prapambetura, me qëllim klasifikimin e tyre në detyrime të prapambetura të cilat do të paguhen nga buxheti i shtetit apo nga buxhetet e veta të njësisve të vetëqeverisjes vendore.

**Rekomandimi 3:** Ministria e Financave dhe Ekonomisë në bashkëpunim me Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit si dhe me Departamentin e Administratës Publike, të marrin masa me qëllim:

**1-Korrigjimin** e dokumentit të Planit Buxhetor Afat Mesëm 2019-2021, në drejtim të planifikimit të fondeve buxhetore për të gjithë pajisjet *Hardëare dhe Softëare* në fushën TIK, me qëllim planifikimin e tyre në buxhetin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, në zbatim të VKM-së, nr. 673, datë 22/11/2017, “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”, i ndryshuar, në fazën e Rishikuar të saj.

-Rishikimin e buxhetit të vitit 2019, me qëllim pakësimin e fondeve buxhetore të pajisjeve.

*Hardëare dhe Softëare* në fushën TIK, për të organet e administratës buxhetore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave me qëllim kalim e këtyre fondeve nën administrimin e AKSHI-it.

-Hartimin e një Formulari Tip, ku të jenë të përcaktuar qartë të dhënat dhe dokumentacioni i nevojshëm shoqërues të cilat nevojiten për transferimin e lëvizjes së Aktiveve TIK.

-Marrjen e masave për monitorimin e këtij procesi kaq të rëndësishëm me qëllim parandalimin e efekteve negative në administrimin e fondeve buxhetore.

-Fuqizimin e kapaciteteve sasiore dhe cilësore të AKSHIT, në drejtim të këtij procesi.

2-Në bazë të Kushtetutës së RSH, udhëzimet duhet të dalin në mbështetje të VKM-ve dhe në zbatim të tyre. Për sa kohë që përmbajtja e udhëzimit bie ndesh me përmbajtjen e VKM-së, udhëzimi nuk është i zbatueshëm dhe është akt absolutisht i pa vlefshëm. Nëse Ministria e Financave dhe Ekonomisë, ka objeksione për VKM-në, atëherë duhet të ndjekë hapat e duhura ligjore për arritjen e synimit tuaj.

**Rekomandimi 4:** Strukturat Drejtueses të MFE, të marrin të gjitha masat e nevojshme me qëllim:

1) Përmirësimin e cilësisë së dokumentit të PBA me qëllim minimizimin e riskut të ndryshimit të buxheteve në fazën e zbatimit të tij dhe si rrjedhojë minimizimin e vonesave që mund të krijohen në financim dhe ecurinë e projektit dhe krijimin e detyrimeve të prapambetura. Gjithashtu përmirësimi i cilësisë së dokumentit të PBA, do të ndikonte pozitivisht në eliminimin e praktikave të realizimit të investimeve kapitale në mbyllje të vitit buxhetor duke ulur në këtë mënyrë riskun e uljes së vëmendjes gjatë procesit të menaxhimit të projekteve të investimit të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në efikasitetin e projekteve të investimeve publike

2) Të merren masa për fuqizimin cilësor të burimeve njerëzore të cilat merren me Menaxhimin e Investimeve Publike.

3) Fuqizimin e rolit të auditit të brendshëm në drejtim të procesit të plotë të Ciklit të Menaxhimit të Investimeve Publike .

4) Me qëllim rritjen e transparencës, për të siguruar përdorimin me efektivitet, efikasitet dhe me ekonomi të burimeve buxhetore të ngrihen instrumenta të qarta ligjore konsultimi me publikun, grupet e interesit dhe sektorin privat për të gjitha projektet e investimit të cilat kanë një vlerë mbi vlerën kufi të përcaktuar në Udhëzimin e Ministrisë përgjegjëse për financat.

5) Shpërndarjen e njëtrajtshme të shpenzimeve kapitale gjatë vitit, me qëllim shmangien e shpenzimeve inefficente dhe krijimin e detyrimeve të prapambetura.

**Rekomandimi 5:** Strukturat Drejtueses të MFE, të marrin të gjitha masat e nevojshme me qëllim forcimin e rolit të Drejtorisë së Menaxhimit të Investimeve Publike në drejtim të monitorimit të procesit të investimeve publike me qëllim rritjen e cilësisë së menaxhimit të fondeve publike dhe llogaridhënies së strukturave që kryejnë shpenzime buxhetore.

**Rekomandimi 6:** Nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të shmanget praktika e akumulimit të mjeteve monetare të papërdorura, si rrjedhojë e marrjes së borxhit të ri për financimin e deficitive buxhetore të viteve pasardhëse. Në të njëjtën kohë të merren masa për shmangien e efekteve negative nga akumulimi i interesave për borxhin e marrë që rri gjendje i papërdorur në llogarinë e unifikuar të thesarit. Në çdo rast realizimi i huamarrjes të ndjekë planin e autorizuar nga Kuvendi për sa i përket të drejtës për të marrë hua apo për të shlyer borxhin ekzistues. Në të njëjtën linjë me situatën e raportuar vitin e kaluar dhe për të cilën nuk është marrë asnjë masë nga MFE për reduktimin e tepicës së likuiditeteve në valutë, ri rekomandojmë uljen e ekspozimit ndaj luhatjeve të kursit të kursit të këmbimit për mjetet monetare gjendje në valutë të huaj.

**Rekomandimi 7:** Në rastet e emetimit të instrumenteve në tregun e jashtëm dhe menaxhimit aktiv të detyrimeve rekomandojmë që Ministria e Financave dhe Ekonomisë të realizojë një analizë më të detajuar risk – kosto. Në çdo rast, këto operacione duhet të paraqiten për miratim në strukturat përkatëse autorizuese dhe e gjithë vendimmarrja të mos jetë ekskluzivitet i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, por të realizohet nëpërmjet marrjes së miratimit përkatës nga Kuvendi.

**Rekomandimi 8:** Ministria e Financave dhe Ekonomisë të marrë masa të menjëhershme për vlerësimin e performancës së projekteve që nuk arrijnë që të shlyejnë detyrimet që rrjedhin nga marrëveshjet e nënhuasë. Në të njëjtën kohë të merren masa për rikuperimin e të drejtave për të arkëtuar nëpërmjet ushtrimit të instrumenteve ligjore që rrjedhin nga marrëveshjet e nënhuasë apo rikompozimin e këtyre marrëveshjeve për tju përshtatur kushteve aktuale të secilit projekt.

**Rekomandimi 9:** Ministria e Financave dhe Ekonomisë të rishikojë kuadrin ligjor për shtimin e instrumentave me qëllim administrimin efikas të riskut të garancive. Në vijim të ushtrijë të gjitha mjetet ligjore për arkëtimin e të drejtave për pagesa të kryera për garancitë e arkëtuara dhe në të njëjtën kohë të ushtrijë kontroll mbi planet ekonomike dhe financiare për shlyerjen e këtyre shumave.

**Rekomandimi 10:**

**a.** Strukturat drejtuese të Ministrisë së Financave/Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit, në bashkëpunim me strukturat menaxhuese të Këshillit të Ministrave, të përcaktojnë në hartimin e ligjit vjetor të buxhetit dhe në udhëzimin vjetor të zbatimit të tij, **klauzolat e alokimit** të Fondit Rezervë të Buxhetit të Shtetit, duke vendosur edhe sanksione për ata që i shkelin këto përcaktime ligjore.

**b.** Strukturat drejtuese të Ministrisë së Financave/Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit, të krijojë për çdo VKM të Fondit Rezervë të Buxhetit të Shtetit, dosjen e dokumentacionit të domosdoshëm për të, në mënyrë që të jetë më e qartë se ku mungon dokumentacioni (në protokoll, apo nuk ka kaluar nga kjo drejtori) dhe të marrin fund justifikimet e përvitshme se “këto mungesa e pasaktësi nuk qëndrojnë, pasi asnjë projektvendim i KM, ku preket fondi rezervë, nuk merr miratimin paraprak të MFE, nëse i mungon përlllogaritja e efekteve financiare”.

**Rekomandimi 11:** Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit në MFE, me strukturat e saj të varësisë, të marrë të gjitha masat për menaxhimin me ekonomicitet dhe efektivitet të likuiditetit, në mënyrë që operacionet monetare që kryen gjatë vitit, të mos krijojnë diferenca të tilla, të cilat rëndojnë buxhetin e shtetit.

**Rekomandimi 12:** Nga MFE të mundësohet likuidimi i vlerës prej 8,815.78 mijë lekë, pagesa për “Vendime gjyqësore për pronat”, i pezulluar si rezultat boshllëkut ligjor midis ligjit organik të buxhetit dhe udhëzimit standart të zbatimit të tij, duke gjetur mënyrën dhe fondet për likuidimin e kësaj shume.

**Rekomandimi 13:** Ministria e Financave dhe Ekonomisë për pagesat e projekteve të Fondit Shqiptar të Zhvillimit me Kod M112821 “Rikonstruksioni i shkollës 9-vjeçare në fshatin Godvi, Njësia Administrative Zerqan”, M112826 “Rikonstruksioni i shkollës 9-vjeçare “Karbunarë e Vogël””, M112823 “Rikonstruksioni i shkollës 9-vjeçare, Tregtan”, M112832 “Rikonstruksioni i shkollës 9-vjeçare “Nënë Tereza”, Laknas”, të cilat janë ekzekutuar me fondet e buxhetit të vitit 2018, të ngrejë grupet e Inspektimit Financiar Publik me qëllim certifikimin e punimeve të kryera, faturave të lëshuara dhe pagesave të kryera.

**Rekomandimi 14:** Strukturat Drejtuese të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të marrin masa për rritjen e kontrolleve për parandalimin e fenomeneve të tilla të cilat ndikojnë negativisht në financat publike.

## **9. MFE: DREJTORIA E PËRGJITHSHME E THESARIT**

Auditimi në Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit është realizuar sipas Programit të Auditimit Nr.694 Prot, datë 16.07.2020 me objekt “Për Zbatimin e Rekomandimeve të lëna në Auditimet e mëparshme, për auditimet e evaduar në periudhën 01.01.2019-31.12.2019” dhe duke u bazuar në punën e grupit të auditimit që e ushtroi auditimin në Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit sipas programit nr.54/1, datë 17.01.2020, i ndryshuar me nr. prot 54/3 datë 28.01.2020.

Në përfundim të misionit auditues në lidhje me verifikimin e dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga KLSH në Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit me shkresën e KLSH nr.240/5 datë 10.10.2019, rezulton në mënyrë të përmbledhur, si më poshtë:

### **KONKLuzioni I Auditimit**

Nga auditimi bazuar në punën e grupit të auditimit sipas programit nr.54/1, datë 17.01.2020, i ndryshuar me nr. prot 54/3 datë 28.01.2020 mbështetur në standardet e INTOSAI-t, Manualit të Përputhshmërisë, Manualit të ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së, i kryer në Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit, rezultoi se për rekomandimet e pranuar niveli i zbatimit të tyre plotësisht, në proces zbatimi ose pjesërisht, është në vlerën 62%.

Në subjektin e audituar, janë rekomanduar gjithsej (14) masa, nga të cilat janë pranuar (13) masa dhe nuk është pranuar (1) masë. Konstatuam se nga (13) masat e rekomanduara dhe të pranuar janë zbatuar plotësisht 4 prej tyre ose 31% , pjesërisht 2 masa ose 15%, në proces 2 masa ose 15% dhe nuk janë zbatuar 5 masa ose 38%.

- Masa Organizative, është lënë 1 rekomandim i cili është pranuar dhe rezulton pjesërisht i zbatuar.

- Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike, përfshi shpenzimet të realizuara në kushte të paligjshmërisë procedurale janë lënë nga 11 rekomandime, nga të cilat është zbatuar 1 rekomandim, në proces 4 rekomandime, pjesërisht zbatuar 2 rekomandime dhe pa zbatuar 4 rekomandime

- Masa administrative është lënë nga 1 rekomandim i cili nuk është pranuar

- Masat disiplinore për personat përgjegjës nga ana e KLSH janë lënë si rekomandim në diskrecion të subjektit dhe konsiderohen të pranuar për sa kohë nuk është shprehur.

**Për sa më sipër rikërkojmë që Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit në Ministrinë e Financave të marrë të gjitha masat e nevojshme me qëllim zbatimin e të gjitha rekomandimeve që rezultuan të pa zbatuara, të zbatuara pjesërisht, në proces zbatimi ose të papranuara, si më poshtë:**

## B.MASAT ORGANIZATIVE

**1.Gjetje nga auditimi** Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve përcjellë me shkresën nr. nr.240/5 datë 10.10.2019, rezultoi i papranuar rekomandimi si vijon:

**Rekomandim 2.1:** Duke vlerësuar si shumë të rëndësishëm saktësinë dhe plotësinë e regjistrimeve të kryera në SIFQ, Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit të hartojë udhëzues mbi informacionin e domosdoshëm të kërkuar për regjistrimet në SIFQ, për strukturat e MFE dhe njësitë ekonomike me akses të plotë në SIFQ, sipas niveleve të të drejtave autorizuese përkatëse me qëllim plotësinë e regjistrimit, gjurmën e auditimit dhe transparencën e veprimeve të kryera në funksion të raportimit të automatizuar, objektiv ky i një sistemi të integruar.

## D. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE, PËRFSHI SHPENZIME TË REALIZUARA NË KUSHTE TË PALIGJSHMËRISË PROCEDURALE

**1.Gjetje nga auditimi** Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve përcjellë me shkresën nr. nr.240/5 datë 10.10.2019, rezultuan të pazbatuar, në proces dhe pjesërisht të zbatuara rekomandimet si vijojnë:

**Rekomandimi 1:** Drejtoritë përgjegjëse dhe NPA në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë të analizojnë problematikat e rrjedhura nga një proces i tejzgjatur i detajimit të planeve buxhetore dhe çeljeve përkatëse në SIFQ, me qëllim vendosjen e afateve konkrete për institucionet qendrore dhe vendore, si hapi i parë për përmirësimin e situatës dhe shmangien e shkeljeve të konstatuara si një fenomen i përhapur në procedurat e marrjes së angazhimeve buxhetore.

**Rekomandim 1.2:** Drejtoritë përgjegjëse dhe NPA në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë të analizojnë problematikat e sipër përmendura për të evidentuar shkaqet e mos përdorimit të SIFQ për regjistrimin në kohë reale të gjithë transaksioneve dhe monitorimin e vazhdueshëm të tyre me qëllim shmangien e mbajtjes së të dhënave dhe veprimeve korigjuese në mënyrë manuale. Për këtë qëllim mund të dizajnohen raporte monitorimi që më pas lehtësisht mund të gjenerohen nga SIFQ në mënyrë periodike. Kjo në funksion të gjurmës së auditimit, saktësisë, plotësisë dhe transparencës së veprimeve të kryera në SIFQ.

**Rekomandimi 1.5:** Ministria e Financave dhe Ekonomisë me drejtoritë e saj përkatëse të analizojë dhe investigojë të gjitha rastet e regjistrimeve me data retrospektive të rishpërndarjeve buxhetore të vitit 2018 me ndikim në saktësinë e raportimeve periodike fiskale për të nxjerrë arsyet dhe përgjegjësitë përkatëse duke theksuar rëndësinë e saktësisë dhe plotësisë së të dhënave në SIFQ si i vetmi burim informacioni për këto raporte.

**Rekomandimi 2.3:** Ministria e Financave dhe Ekonomisë me drejtoritë përkatëse të saj të marrë në shqyrtim nëse zbatohet Metodologjia për Monitorimin e Investimeve Publike. Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit në bashkëpunim dhe me Drejtorinë e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollin të Brendshëm Financiar Publik të marrë në konsideratë përfshirjen e numrit të rishpërndarjeve për çdo njësi në grupin e treguesve të matjes së performancës financiare në kontekstin e pikës 79 të Udhëzimit të përhershëm nr.2 dt.06.12.2012 dhe Urdhrit nr.89 datë 28.12.2015.

**Rekomandimi 2.1:** Duke vlerësuar si shumë të rëndësishëm saktësinë dhe plotësinë e regjistrimeve të kryera në SIFQ, Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit të hartojë udhëzues mbi informacionin e domosdoshëm të kërkuar për regjistrimet në SIFQ, për strukturat e MFE dhe njësitë ekonomike me akses të plotë në SIFQ, sipas niveleve të të drejtave autorizuese përkatëse me qëllim plotësinë e regjistrimit, gjurmën e auditimit dhe transparencën e veprimeve të kryera në funksion të raportimit të automatizuar, objektiv ky i një sistemi të integruar.

**Rekomandimi 2.2:** Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit të marrë masa për plotësimin e procedurës së marrjes së vulës në Urdhër-prokurimet e paraqitura pranë tyre nga njësitë ekonomike pa akses në SIFQ, me qëllim vendosjen në vulën e Degës së Thesarit të datës së paraqitjes së dokumentit. Gjithashtu në zbatim të strategjisë për parandalimin e detyrimeve të prapambetura deri në implementimin e plotë dhe efektiv të komunikimit të sistemit SIFQ me të dhënat e sistemit të APP, Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit të përpilojë raporte periodike mujore për rakordimin e të dhënave midis dy institucioneve për numrin dhe llojin e prokurimeve përkatëse të çdo muaji.

**Rekomandimi 2.3:** Ministria e Financave dhe Ekonomisë me drejtoritë e saj përkatëse të ndërmarrë masa për grumbullimin e informacionit të plotë mbi kontratat e migruara nga programet e Ministrive të përthithura që nga ristrukturimi i vitit 2017 dhe nga reforma administrative territoriale e qeverisjes vendore, me qëllim migrimin e saktë dhe të plotë të këtyre angazhimeve të përgjithshme deri më sot.

**Rekomandimi 2.5:** Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit të përgatisë një memo/ udhëzim për të gjithë Degët e Thesarit me qëllim qartësimin dhe theksimin e hapave dhe dokumenteve të domosdoshëm për regjistrimin e transaksioneve lidhur me kontratat shumëvjeçare. Pjesë e këtij udhëzuesi të jenë edhe raporte standarde periodike të dizajnuara me qëllim identifikimin në kohë të rasteve, Degëve apo njërive përgjegjëse me akses të plotë në SIFQ.

**Rekomandimi 4.1:** Ministria e Financave dhe Ekonomisë me drejtoritë e saj përkatëse të ndërmarrë analiza të mirëfillta dhe të detajuara në lidhje me problematikat e konstatuara në operacionet e kryera, si nga BI-Online dhe BI-Offline me qëllim marrjen e masave konkrete dhe efektive për përmirësimin e një situatë me problematika sistematike dhe të vazhdueshme, përmes vënies në funksionalitet të plotë të sistemeve të kontrollit të brendshëm jo vetëm si kontrole detektuese/zbuluese por kryesisht si parandalues të situatave që krijojnë paligjshmëri, jo efektivitet dhe inefficiencë në përdorimin e fondeve publike.

**Rekomandimi 4.2:** SIFQ duhet të shërbejë si një sistem themelor bazë për një programim sa më real dhe kredibël të buxhetit të shtetit si i vetmi sistem që raporton treguesit fiskal në vend, dhe për të arritur në këtë pikë strukturat përgjegjëse në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për hartimin e buxhetit duhet të orientohen nga analiza e të dhënave që prodhon ky sistem dhe jo të dhënat e mbajtura jashtë këtij sistemi që nuk ofrojnë siguri dhe transparencë të kërkuar në menaxhimin e financave publike.

#### F. MASA ADMINISTRATIVE:

**1.Gjetje nga auditimi** Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve përcjellë me shkresën nr. nr.240/5 datë 10.10.2019, rezultoi i pazbatuar rekomandimi si vijon:

KLSH i rekomandon Nëpunësit të Parë Autorizues marrjen e masave në përputhje me kërkesat e nenit 51 “Menaxhimi i Angazhimeve” dhe nenit 71 “Kundravajtjet administrative” të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe akteve nënligjore në fuqi, ndaj Nëpunësve Autorizues dhe Zbatues në entet publike të konstatuara me shkelje të procedurave për disiplinimin fiskal, duke analizuar rast pas rasti gjetjet e mësipërme, dhe të reflektuara më hollësisht në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

Në përgjegjësi të NA të ministrive të linjës dhe institucioneve buxhetore të kërkojnë nga njësitë audituese të tyre të nxjerrin përgjegjësit në vijim të shkresave të vëmendjes mbi mos-respektimin e legjislacionit në fuqi të konstatuar nga degët e Thesarit gjatë ekzekutimit të buxhetit.

### **10. DREJTORIA E PËRGJITHSHME E HARMONIZIMIT TË KONTROLLIT TË BRENDSHËM FINANCIAR PUBLIK, NË MINISTRINË E FINANCEVE DHE EKONOMISË**

Auditimi në *Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë* është realizuar sipas Programit të Auditimit Nr.694 Prot, datë 16.07.2020 me objekt: “Për Zbatimin e Rekomandimeve të lëna në Auditimet e mëparshme, për auditimet e evaduar në periudhën 01.01.2019-31.12.2019” dhe duke u bazuar në punën e grupit të auditimit që ushtroi auditimin në *Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë* sipas programit nr. 458/1 Prot., datë 09/06/2020 me objekt “Auditim mbi Përputhshmërinë”.

Në përfundim të misionit auditues në lidhje me verifikimin e dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga KLSH në Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit dhe Borxhit me shkresën prot nr.238/2, datë 14.08.2019.

#### **KONKLUZIONI I AUDITIMIT**

Nga auditimi i bazuar në punën e grupit të auditimit që ushtroi auditimin në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë sipas programit nr. 458/1 Prot., datë 09/06/2020 me objekt “Auditim mbi Përputhshmërinë” mbështetur në standardet e INTOSAI-t, Manualit të Përputhshmërisë, Manualit të ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve së KLSH-së, i kryer në Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit dhe Borxhit, rezultoi se për rekomandimet e pranuaru niveli i zbatimit të tyre plotësisht, në proces zbatimi ose pjesërisht, është në vlerën 78%.

Në subjektin e audituar, janë rekomanduar gjithsej (29) masa, nga të cilat janë pranuar (22) masa dhe nuk janë pranuar (7) masa. Konstatuam se nga (22) masat e rekomanduara dhe të pranuar janë zbatuar plotësisht 5 prej tyre ose rreth 21.5% , në proces 13 masa ose rreth 57 % dhe nuk janë zbatuar 5 masa ose 21.5%.

- Masa Organizative 27, të cilat janë të ndara në: 13 drejtuar Drejtorisë së Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (DH/MFK) (Nga të cilat janë pranuar 8 masa organizative, 5 masa organizative në proces zbatimi, 1 masa organizative është realizuar dhe 2 masa organizative nuk janë realizuar, ndërkohë që 5 masa organizative nuk ishin pranuar.

- 14 drejtuar Drejtorisë së Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm (DH/AB) (Nga të cilat 8 masa organizative janë në proces realizimi, 3 masa organizative janë realizuar dhe 3 masa organizative janë të pa realizuara.

-Masat disiplinore për personat përgjegjës rezultojnë të pazbatuar.

**Për sa më sipër rikërkojmë që Drejtoria e Përgjithshme të Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik të marrë të gjitha masat e nevojshme me qëllim zbatimin e të gjitha rekomandimeve që rezultuan të pa zbatuara, të zbatuara pjesërisht, në proces zbatimi ose të papranuara, si më poshtë:**

## B. MASA ORGANIZATIVE

### B.1. REKOMANDIME PËR DREJTORINË E HARMONIZIMIT TË AUDITIMIT TË BRENDSHËM (DH/AB).

**Gjetje nga auditimi** Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve përcjellë me shkresën prot nr.238/2, datë 14.08.2019, **rezultuan të pazbatuara, të papranuara, të zbatuara pjesërisht, në proces zbatimi rekomandimet, si vijon:**

**Rekomandimi 1.1:** Ministri i Financave dhe Ekonomisë, të marrë masat për përfshirjen në detyrat funksionale të Drejtorisë së Harmonizimit të Auditit të Brendshëm, sigurimin e informacionit për krijimin dhe funksionimin e Komiteteve të auditimit pranë njësive publike dhe monitorimi i veprimtarive respektive, me synim garantimin e pavarësisë së strukturave të AB.

**Rekomandimi 1.2:** Drejtoria e Harmonizimit të Auditit të Brendshëm, në vijim edhe të rekomandimeve të lëna nga auditimi i përfaqësuesve të Komisionit Europian, të marrë masat për të përcjellë pranë Komiteteve të Auditimit, detyrimin për të kërkuar informacion nga njësitet e auditit të brendshëm në strukturat ku janë ngritur këto njësi, dhe varësitë respektive, mbi gjetjet dhe rekomandimet e konstatuara në raporte, përpara dërgimit të tyre tek titullari i njësive, me qëllim sigurimin e pavarësisë së veprimtarisë së auditit të brendshëm.

**Rekomandimi 2.1:** DH/AB të marrë masat në mënyrë të menjëhershme për kryerjen e një analize me qëllim identifikimin e nevojave për mbulim me auditim të brendshëm në rang kombëtar dhe përcjelljen e këtij informacioni pranë Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, duke mos kryer një raportim të sistemeve të KBFP vetëm bazuar në të dhënat e njësive që kanë raportuar pranë kësaj drejtorie.

**Rekomandimi 3.1:** DH/AB në funksion të përgjegjësive të saj, të përcjellë në mënyrë sistematike pranë Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, krijimin dhe plotësimin e njësive të auditimit të brendshëm publik, me numrin dhe eksperiencën e audituesve, në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e bëra në VKM nr.83, datë 03.02.2016 "Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik".

**Rekomandimi 5.1:** DH/AB në funksion të përgjegjësive të saj, të përcjellje në mënyrë sistematike të lëvizjeve pranë Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, sidomos për hyrjet apo daljet të cilat bien në kundërshtim me kërkesat e ligjit, duke rekomanduar edhe masa të

nevojshme për përmirësimin e mënyrës së kryerjes së trajnimeve, përzgjedhjes së lektorëve dhe tematikave të trajtuara, duke bërë edhe publikimet në faqen zyrtare të Ministrisë Financave dhe Ekonomisë.

**Rekomandimi 7.1:** DH/AB të bëjë një analizë të drejtë dhe të plotë të nivelit të gjetjeve në raport me shtrirjen e strukturës AB në sektorin publik, llojeve të gjetjeve dhe në reflektim të rekomandimeve të KLSH-së, si auditues i jashtëm, dhe të raportojë në vazhdimësi pranë Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, nivelin e strukturave AB dhe eficientësisë së punës së tyre. Plotësia dhe saktësia e raportimit mbi këtë sistem është jo vetëm obligim ligjor por edhe përgjegjshmëri ndaj funksioneve që kryhen.

**Rekomandimi 8.1:** Drejtoria DH/AB të marrë masat për rishikimin e të dhënave statistikore konkretisht të pasqyrës së raportimit të shkallës së zbatimit të rekomandimeve në manualin e auditit të brendshëm, në mënyrë që të kryhet saktë raportimi i situatës nga njësitë e auditit të brendshëm duke identifikuar **gjetjet e pazbatuara nga ato në proces zbatimi** si dhe të saktësohen të dhënat e Raportit Vjetor të raportuar pranë Ministrit dhe Kryeministrit.

**Rekomandimi 9.1:** DH/AB si organi përgjegjës për monitorimin dhe vlerësimin në mënyrë periodike të veprimtarisë së NJAB të studiojë me përgjegjësi kapacitetet audituese që ka për mbulimin e detyrave funksionale që rrjedhin nga neni 24 i LAB dhe t'i propozojë Ministrit të Financave dhe Ekonomisë gjetjen e rrugëve efektive për realizimin e objektivit prej 25 vlerësime të jashtme të cilësisë çdo vit.

**Rekomandimi 10.1:** Ministri i Financave dhe Ekonomisë në cilësinë e përgjegjës për bashkërendimin e përgjithshëm, harmonizimin dhe monitorimin e veprimtarisë së AB të shfuqizojë nenin 23 të rregullores nr. 37, datë 10.03.2016 i cili specifikon se “Dokumentet zyrtare që përgatiten lidhur me procesin e çertifikimit dorëzohen dhe ruhen në protokollin e Ministrisë së Financave në përputhje me legjisllacionin në fuqi, **me përjashtim të fletoreve të provimeve dhe riprovimeve të kandidatëve pjesëmarrës, të cilat ruhen jo më shumë se 3 muaj nga data e dhënies së provimit/riprovimit** si dhe të urdhërojnë veçimin dhe asgjësimin e dokumentacionit të përkohshëm në përputhje me normat tekniko profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, dhe vetëm pas një kontrolli/auditimi nga një strukturë e brendshme apo dhe e jashtme auditimi për të marrë siguri për këtë proces të rëndësishëm.

**Rekomandimi 11.1:** DH/AB në bashkëpunim me KKAB të marrë masat për rishikimin e rregullores së trajnimit të vijueshëm profesional, me qëllim përfshirjen e procedurave që do të ndiqen në rastet e dorëheqjes së trajnerëve gjatë implementimit të programit vjetor të trajnimit të vijueshëm.

**Rekomandimi 12.1:** Ministri i Financave dhe Ekonomisë në vijim të konstatimeve të trajtuara dhe të dokumentacioneve, të vendosë mbi vlefshmërinë e vendimit të Komisionit të KKAB si dhe të analizojë veprimet dhe mosveprimet e funksionarëve të shtetit në ushtrimin e detyrave funksionale në përputhje me Kodin e Etikës.

## B.2.GJETJE DHE REKOMANDIME PËR DREJTORINË E HARMONIZIMIT TË MENAXHIMIT FINANCIAR DHE KONTROLLIT (DH/MFK).

**Gjetje nga auditimi** Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve përcjellë me shkresën prot nr.238/2, datë 14.08.2019, **rezultuan të pazbatuara, të papranuara, të zbatuara pjesërisht, në proces zbatimi rekomandimet, si vijon:**

**Rekomandimi 1.1:** Strukturat Drejtuese të DH/MFK të marrin masat për rishikimin e manualit të MFK në përputhje me ndryshimet e pyetësorit të vetëvlerësimit të kontrollit të brendshëm me qëllim përfshirjen e udhëzimeve sqaruese për mënyrën se si do të raportohet nga njësitë dhe si do të kryhet vlerësimi nga DH/MFK, me qëllim raportimin e një shtate sa më reale mbi



sistemet e kontrollit të brendshëm si nga ana e institucioneve publike, ashtu edhe nga vlerësimi që kryhen drejtoria.

**Rekomandimi 2.1:** DH/MFK të marrë masat për kryerjen e një vlerësimi bazuar në të dhënat totale të dorëzuara nga njësi publike sipas kërkesave të pyetësorit të rishikuar, me qëllim identifikimin e mangësive për çdo njësi publike që ka kryer dorëzimin e këtij dokumenti pranë kësaj drejtorie.

**Rekomandimi 3.1:** Strukturat drejtuese të DH/KBFP të marrin masa të menjëhershme për rishikim të procedurave të ndjekura për kryerjen e vlerësimit në vend të njësive publike për elementët e kontrollit të brendshëm financiar publik, duke rritur numrin e vizitave, si dhe duke përmirësuar praktikën e punës të ndjekur për raportimin e rezultateve, dhe ndjekjen e rekomandimeve me qëllim ndërmarrjen e iniciativave konkrete për monitorimin e sistemeve të KBFP.

**Rekomandimi 4.1:** Në vijim edhe të rekomandimeve të mëparshme të KLSH, DH/KBFP të marrë masat për raportimin e plotë të sistemeve të KBFP duke përfshirë edhe njësitë e varësisë, nëpërmjet konsolidimit të të dhënave të tyre nga njësitë publike që raportojnë pranë kësaj drejtorie. Bordi i KBFP të analizojë problematikën e ngritur në vijimësi nga KLSH dhe të marrë masat e nevojshme për funksionimin e DH/KBFP në përmbushje të misionit monitorues dhe raportues të këtyre sistemeve.

**Rekomandimi 4.2:** Strukturat Drejtuese të DH/KBFP, në vijim edhe të kërkesave të indikatorëve të Strategjisë PFM, për vlerësimin e përqindjes së efektivitetit të kontroleve të brendshme, të marrin masat për kryerjen e një përlllogaritjeje të plotë dhe gjithëpërfshirëse për raportimin e saktë të efektivitetit të sistemit të kontrollit financiar publik, në mënyrë që të ndiqet në mënyrë krahasimore kjo analizë me vitet e mëparshme dhe të garantohet forcimi i sistemeve, reflektuar në rritjen e nivelit të efektivitetit. Nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë të vlerësohet situata e mësipërme dhe të nxirren përgjegjësitë për raportim jo të drejtë referuar situatës së efektivitetit të sistemeve të kontrollit të brendshëm.

**Rekomandimi 5.1:** Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit të marrë masat për kryerjen në mënyrë sa më efektive të planifikimit dhe implementimit të sistemeve të MFK në institucionet pilot, në mënyrë që të realizohen pritshmëritë e Strategjisë së Menaxhimit të Financave Publike në fushën e sistemeve të kontrollit të brendshëm financiar publik, duke kryer shoqërimin e këtyre vizitave me letrat e punës që dokumentojnë arritjen e objektivave të paracaktuar, për forcimin e sistemeve të MFK në njësitë respektive.

**Rekomandimi 6.1:** DH/KBFP të marrë masat për kryerjen e vlerësimit në pikë në bazë të përgjigjeve reale të dhëna nga institucionet raportuese pranë drejtorisë, sipas udhëzimit për kryerjen e këtij vlerësimi në pikë nga DH/AB dhe DH/MFK, me qëllim raportimin e saktë të situatës sipas përgjigjeve të institucioneve.

**Rekomandimi 7.1:** DH/MFK në vijim edhe të konstatimeve të mëparshme të KLSH, të marrë masat për ndërmarrjen e iniciativave konkrete për implementimin e objektivave të strategjisë së PFM me objektiv kryesor përgatitjen e pasqyrave financiare sipas standardeve të kontabilitetit publik.

**Rekomandimi 9.1:** DH/MFK të rishikojë menjëherë Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes përgjithshme”, me qëllim harmonizimin e tij me ligjin për menaxhimin e buxhetit dhe Udhëzime të tjera në fushën e kontabilitetit.

**Rekomandimi 10.1:** Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, si institucion përgjegjës për raportimin dhe monitorimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në sektorin publik, të marrë masat për përgatitjen dhe shpërndarjen e pyetësorëve të veçantë dhe të personalizuar sipas grupeve, për institucionet e varësisë, shoqëritë tregtare, OJF, autoritetet e përbashkëta apo institucione të tjera të financuara nga buxheti i shtetit apo që kanë në përdorim asete shtetërore, në mënyrë që këto institucione, si njësi të sektorit publik

përgjegjëse për zbatimin e ligjit të MFK, të bëhen pjesë e raportit të KBFP dhe të monitorohen nga DH/MFK për funksionimin sa më të mirë dhe efikas të sistemeve të tyre në zbatim të manualit dhe ligjit të MFK.

**Rekomandimi 12.1.:** Për përmbushjen e misionit dhe detyrave funksionale të përcaktuara në kuadrin ligjor në fuqi në lidhje me auditimin e brendshëm publik dhe menaxhimin financiar dhe kontrollit, nga ana e Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë, sipas legjislacionit në fuqi, të bëjë të mundur shpalljen dhe plotësimin e vendeve vakant në Drejtorinë e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik.

## G. MASA DISIPLINORE

Në mbështetje të shkronjës (c) neni 15 -Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për mos zbatim jo të plotë të nenit 24-Përgjegjësitë e strukturës përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm, të ligjit nr. 114/2015 datë 22.10.2015 “Për auditin e brendshëm në sektorin publik”, në zbatim të shkronjës (a), neni 58, “llojet e masave disiplinore” të ligjit nr. 152/2013 datë 30.05.2017 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar me ligjin nr. 178/2014, datë 18.12.2014, VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, *i rekomandojmë* Ministrisë Financave dhe Ekonomisë që të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore **“Vërejtje” deri në “Largim nga detyra”, për 2 punonjësit e mëposhtëm:**

1. **Znj. K. H**, Drejtor i Përgjithshme i Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

2. **Z. D.F**, Drejtori i Drejtorisë së Harmonizimit MFK, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

## 11. MFE: DREJTORIA E KONCESIONEVE

Auditimi në **Drejtorinë e Koncesioneve në Ministrinë e Financave** është realizuar në bazë të Programit të Auditimit Nr.694 Prot, datë 16.07.2020 me objekt: Verifikimit i zbatimit të rekomandimeve të dërguara në Drejtorinë e Koncesioneve në Ministrinë e Financave nga Kontrolli i Lartë i Shtetit.

Në përfundim të misionit auditues në lidhje me verifikimin e dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga KLSH në Drejtorinë e Koncesioneve në Ministrinë e Financave me shkresën nr.238/11 prot, datë 09.01.2020, rezulton në mënyrë të përmbledhur, si më poshtë:

### KONKLUZIONI I AUDITIMIT

Nga auditimi tematik mbështetur në standardet e INTOSAI-t, Manualit të Përputhshmërisë, Manualit të ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve së KLSH-së, i kryer në Drejtorinë e Koncesioneve në Ministrinë e Financave, rezultoi se për rekomandimet e pranuar niveli i zbatimit të tyre plotësisht ose në proces zbatimi, është në vlerën 74%.

Në subjektin e audituar, janë rekomanduar gjithsej (23) masa, nga të cilat janë pranuar (19) masa, nuk janë pranuar (3) masa dhe nuk është shprehur për (1) masë. Konstatuam se nga (19) masat e rekomanduara dhe të pranuar janë zbatuar plotësisht 0 prej tyre, pjesërisht 5 masa, ose 26.3%, konsiderohen në proces zbatimi 6 masa, ose 31.6%, dhe pa zbatuar 5 masa, të cilat përfaqësojnë 26.3%.

- Nga 2 masa për propozime për ndryshime apo përmirësime në legjislacionin në fuqi, rezulton se 2 masa janë pranuar dhe rezultojnë të pazbatuara.

- Nga 20 masa organizative të rekomanduara, janë pranuar 17 masa organizative, nga të cilat 6 masa janë në proces zbatimi, dhe 11 masa rezultojnë të pa zbatuara.  
- Masat disiplinore për personat përgjegjës nga ana e KLSH janë lënë si rekomandim në diskrecion të subjektit dhe i konsiderojmë të pranuar për sa kohë nuk është shprehur.

**Për sa më sipër rikërkojmë që Drejtoria e Koncesioneve, Ministria e Financave dhe Ekonomisë të marrë të gjitha masat e nevojshme me qëllim zbatimin e të gjitha rekomandimeve që rezultuan të pa zbatuara, të zbatuara pjesërisht, në proces zbatimi ose të papranuara, si më poshtë:**

#### **A. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI**

**Gjetje nga auditimi** Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve përcjellë me shkresën nr.238/11 prot, datë 09.01.2020, rezultuan të pa zbatuara, të zbatuara pjesërisht, në proces zbatimi ose të papranuara, **si vijon:**

**Rekomandimi 1:** Nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, të iniciohet puna për të rishikuar ligjin për koncesionet, duke synuar një përafrim të plotë me kuadrin rregullator europian në ato aspekte ku devijimet janë më të mëdha si dhe duke ndaluar pranimin e propozimeve të pa kërkuara për të gjitha fushat, pra edhe në fushën e porteve, aeroporteve, energjisë elektrike dhe asaj të rinovueshme. Në kuadër të këtyre ndryshimeve është e nevojshme të vlerësohen me kujdes të gjitha sygjerimet e dhëna nga FMN dhe BB në kuadër të menaxhimit të kujdesshëm të financave publike dhe vlerësimit korrekt të risqeve fiskale që shoqërojnë rritjen e mëtejshme të përdorimit të këtij instrumenti, realizimin e punimeve apo shërbimeve publike përmes partneritetin publik privat.

Për sa kohë që mundësia e kontrolleve shtetërore është e limituar, të sanksionohet që në kontrata të tilla të rëndësishme të mos marrin pjesë kompani që operojnë në sisteme off-shore apo që nuk kanë historik të mjaftueshëm të aktivitetit dhe eksperiencës në fushat ku konkurojnë për të fituar të drejtën e koncesionarit.

**Rekomandimi 2:** Përsa kohë standartet e kontabilitetit dhe raportimit financiar të sektorit publik nuk janë në zbatim nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, të merren masa për nxjerrjen e një udhëzimi lidhur me kërkesat e raportimit financiar të koncesioneve me qëllim përafrimin e tyre me standartet e fushës.

Të merren masa për realizimin e ndryshimeve të nevojshme me qëllim saktësimin e VKM-ve rregulluese në zbatim të ligjit nr.125/2013 datë 25.04.2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, të ndryshuar, që bazohen në një standard jo më efektiv, duke kërkuar njëkohësisht, përfshirjen e detyrimeve që rrjedhin nga këto kontrata koncesionare/PPP në stokun e borxhit publik.

#### **B. MASA ORGANIZATIVE**

**Projekti koncesionar/PPP “Ndërtim landfilli, inceneratori dhe rehabilitimi i venddepozitimeve ekzistuese Tiranë”.**

**1.Gjetje nga auditimi** Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve përcjellë me shkresën nr.238/11 prot, datë 09.01.2020, rezultuan të pa zbatuar, në proces zbatimi rekomandimet, si vijon:

**Rekomandimi 1.1:** Nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të merren masa për bllokimin e projekteve koncesionare që do të paraqiten nga Autoritetet Kontraktore, të cilat nuk kanë të pasqyruar të gjithë elementët e kostove të nevojshme për tu realizuar të projektit në analizën ekonomike dhe financiare.

**Rekomandimi 1.2:** Nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të merren masa për refuzimin e projekteve të cilat përfshijnë angazhime nga palë të treta në analizën ekonomike dhe financiare dhe nga të cilat nuk janë marrë dakortësitë sipas parashikimeve në studimin e fizibilitetit.

**Rekomandimi 1.3:** MFE, me qëllim ezaurimin e të gjitha hapave ligjore për eliminimin e efekteve negative financiare për Buxhetin e Shtetit nga miratimi i projekteve koncesionare me mangësi, të kthejë për plotësim/korigjim pranë Autoriteteve Kontraktuese projektet që paraqesin gabime dhe mangësi në drejtim të treguesve financiarë të cilat janë të paargumentuara dhe marrin përsipër angazhime financiare dhe jo-financiare që prodhojnë risqe fiskale, ose ti refuzojë ato nëse këto gabime dhe mangësi nuk plotësohen.

**Rekomandimi 1.4:** Nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të refuzohen projektet me analiza minimale të alternativave të prokurimit përkundrejt koncesionimit, të gabuara dhe pa marrë në konsideratë të gjithë elementët e vlerës në kohë të parasë për flukset dalëse dhe hyrëse. MFE gjatë shqyrtimit përfundimtar të studimit të fizibilitetit të verifikojë dhe vlerësojë nëse janë përmbushur të gjitha kërkesat ligjore të hartimit të një studimi fizibiliteti.

**Rekomandimi 1.5:** Nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë ti kërkohet autoriteteve kontraktuese që për këto lloj projektesh që mbartin risqe me efekt të drejtpërdrejtë në Buxhetin e Shtetit të kryejnë domosdoshmërisht jo vetëm një analizë cilësore të riskut por edhe një analizë sasiore të tij me qëllim që të identifikohet dhe vlerësohet gama e riskut që mund të ndikojë mbi projektin si dhe në drejtim të efekteve të pritshme në Buxhetin e Shtetit.

Në çdo rast, miratimi apo refuzimi i projekteve nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, të bëhet vetëm pasi të analizohen efektet në pagesat e kërkuara nga Buxheti i Shtetit duke treguar që flukset e parasë janë brenda mundësisë së përdoruesve dhe autoritetit kontraktues, por edhe në kuadrin e qëndrueshmërisë fiskale.

**Projekti koncesionar/PPP “Projektimi, ndërtimi, financimi dhe mirëmbajtja e segmentit rrugor Milot - Balldren”.**

**1.Gjetje nga auditimi** Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve përcjellë me shkresën nr.238/11 prot, datë 09.01.2020, **nuk janë zbatuar, janë në proces zbatimi rekomandimet, si vijon:**

**Rekomandimi 2.1:** Nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë t’i kërkohet autoriteteve kontraktuese që të sigurojnë/konfirmojnë që të dhënat mbi standartet e përdorura për projektimin e rrugëve të jenë të argumentuara referuar strategjive si dhe të sigurojnë përputhshmërinë me nevojat për kryerjen e këtyre investimeve.

**Rekomandimi 2.2:** Nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të kthehen për plotësim/korigjim pranë Autoritetit Kontraktues projektet që paraqesin struktura financimi të paqëndrueshme dhe të paargumentuara ose të refuzohen në rast se këto parregullsi nuk korigjohen me qëllim ezaurimin e të gjithë hapave ligjore për eliminimin e efekteve negative financiare për Buxhetin e Shtetit.

**Rekomandimi 2.3:** Nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të refuzohen projektet të cilat e mbështesin arsyetimin e vendimit për dhënien me PPP në të dhëna të gabuara dhe të paargumentuara. Nga ana e MFE t’i kërkohet autoriteteve kontraktuese që studimi i fizibilitetit të shprehë një vlerësim të investimit në total, të kostove operative dhe të mirëmbajtjes në përputhje dhe sipas standarteve dhe Manualeve Teknike të Çmimeve të Punëve të Ndërtimit

dhe analizave teknike të tyre si dhe këto projekte koncesionare të vlerësohen edhe nga institucionet përkatëse në formatin e oponencës teknike.

**Rekomandimi 2.4:** Nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë ti kërkohet Autoritetit Kontraktues që për këto lloj projektesh që mbartin risqe me efekt të drejtpërdrejtë në Buxhetin e Shtetit të kryejnë domosdoshmërisht jo vetëm një analizë cilësore të riskut por edhe një analizë sasiore të tij me qëllim që të identifikohet dhe vlerësohet gama e riskut që mund të ndikojë mbi projektin si dhe në drejtim të efekteve të pritshme në Buxhetin e Shtetit. Risku i kursit të këmbimit të shmanget në çdo rast duke mos nënshkruar kontrata në monedha të huaja. Të merren masa të menjëhershme për adresimin e plotë të problematikave të evidentura në studim me efekt në kontratë.

Në çdo rast, miratimi apo refuzimi i projekteve nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, të bëhet vetëm pasi të analizohen efektet në pagesat e kërkuara nga Buxheti i Shtetit duke treguar që flukset e parasë janë brenda mundësisë së përdoruesve dhe autoritetit kontraktues, por edhe në kuadrin e qëndrueshmërisë fiskale.

### **Projekti koncesionar/PPP “Projektimi, ndërtimi, financimi dhe mirëmbajtja e segmentit rrugor Thumanë - Kashar”.**

**Gjetje nga auditimi** Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve përcjellë me shkresën nr.238/11 prot, datë 09.01.2020, rezultuan të pa zbatuar, në proces zbatimi rekomandimet, si vijon::

**Rekomandimi 3.2:** Nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të refuzohen projektet të cilat e mbështesin arsyetimin e vendimit për dhënien me PPP në të dhëna të gabuara dhe të paargumentuara. Nga ana e MFE t’i kërkohet autoriteteve kontraktuese që studimi i fizibilitetit të shprehë një vlerësim të investimit në total, të kostove operative dhe të mirëmbajtjes në përputhje dhe sipas standarteve dhe Manualeve Teknike të Çmimeve të Punëve të Ndërtimit dhe analizave teknike të tyre si dhe këto projekte koncesionare të vlerësohen edhe nga institucionet përkatëse në formatin e oponencës teknike.

**Rekomandimi 3.3:** Nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë ti kërkohet Autoritetit Kontraktues që për këto lloj projektesh që mbartin risqe me efekt të drejtpërdrejtë në Buxhetin e Shtetit të kryejnë domosdoshmërisht jo vetëm një analizë cilësore të riskut por edhe një analizë sasiore të tij me qëllim që të identifikohet dhe vlerësohet gama e riskut që mund të ndikojë mbi projektin si dhe në drejtim të efekteve të pritshme në Buxhetin e Shtetit.

Risku i kursit të këmbimit të shmanget në çdo rast duke mos nënshkruar kontrata në monedha të huaja. Të merren masa të menjëhershme për adresimin e plotë të problematikave të evidentura në studim me efekt në kontratë.

Në çdo rast, miratimi apo refuzimi i projekteve nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, të bëhet vetëm pasi të analizohen efektet në pagesat e kërkuara nga Buxheti i Shtetit duke treguar që flukset e parasë janë brenda mundësisë së përdoruesve dhe autoritetit kontraktues, por edhe në kuadrin e qëndrueshmërisë fiskale.

### **Projekti koncesionar/PPP “Projektimi, ndërtimi, financimi dhe mirëmbajtja e segmentit rrugor Orikum - Dukat”.**

**Gjetje nga auditimi** Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve përcjellë me shkresën nr.238/11 prot, datë 09.01.2020, rezultuan të pa zbatuar, në proces zbatimi rekomandimet, si vijon::

**Rekomandimi 4.1:** Nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të kthehen për plotësim apo korigjim pranë autoriteteve kontraktuese projektet që paraqesin struktura financimi të paqëndrueshme dhe të cilat janë të paargumentuara ose të refuzohen në rast se këto parregullsi nuk korigjohen me qëllim ezaurimin e të gjithë hapave ligjore për eliminimin e efekteve negative financiare për Buxhetin e Shtetit.

**Rekomandimi 4.2:** Nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të refuzohen projektet të cilat e mbështesin arsyetimin e vendimit për dhënien me PPP në të dhëna të gabuara dhe të paargumentuara. Nga ana e MFE t'i kërkohet autoriteteve kontraktuese që studimi i fizibilitetit të shprehë një vlerësim të investimit në total, të kostove operative dhe të mirëmbajtjes në përputhje dhe sipas standarteve dhe Manualeve Teknike të Çmimeve të Punëve të Ndërtimit dhe analizave teknike të tyre si dhe këto projekte koncesionare të vlerësohen edhe nga institucionet përkatëse në formatin e oponentëve teknike.

**Rekomandimi 4.3:** Nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë ti kërkohet autoriteteve kontraktuese që për këto lloj projektesh që mbartin risqe me efekt të drejtpërdrejtë në Buxhetin e Shtetit të kryejnë domosdoshmërisht jo vetëm një analizë cilësore të riskut por edhe një analizë sasiore të tij me qëllim që të identifikohet dhe vlerësohet gama e riskut që mund të ndikojë mbi projektin si dhe në drejtim të efekteve të pritshme në Buxhetin e Shtetit. Risku i kursit të këmbimit të shmanget në çdo rast duke mos nënshkruar kontrata në monedha të huaja. Të merren masa të menjëhershme për adresimin e plotë të problematikave të evidentura në studim me efekt në kontratë.

Në çdo rast, miratimi apo refuzimi i projekteve nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, të bëhet vetëm pasi të analizohen efektet në pagesat e kërkuara nga Buxheti i Shtetit duke treguar që flukset e parasë janë brenda mundësisë së përdoruesve dhe autoritetit kontraktues, por edhe në kuadrin e qëndrueshmërisë fiskale.

### **Projekti koncesionar/PPP “Për ofrimin e shërbimit laboratorik të spitaleve universitare, rajonale dhe atyre bashkiake të Sarandës dhe Lushnjes”.**

**Gjetje nga auditimi** Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve përcjellë me shkresën nr.238/11 prot, datë 09.01.2020, rezultuan të pa zbatuar, në proces zbatimi rekomandimet, si vijon::

**Rekomandimi 5.1:** MFE në analizën e përballeshmërisë së projekteve ti kërkojë Autoritetit Kontraktues të përcaktojë efektin e kostove në shtesën për financim duke u siguruar për të dhënat sasiore dhe tarifat përkatëse përpara miratimit të projekteve. Në çdo rast të refuzohen projektet të cilat nuk janë të përballeshme dhe të pa mbështetura në PBA përkatëse në momentin e miratimit.

**Rekomandimi 5.2:** Nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të kthehen për plotësim apo korigjim pranë autoriteteve kontraktuese projektet që paraqesin struktura financimi të paqëndrueshme dhe të cilat janë të paargumentuara ose të refuzohen në rast se këto parregullsi nuk korigjohen me qëllim ezaurimin e të gjithë hapave ligjore për eliminimin e efekteve negative financiare për Buxhetin e Shtetit.

**Rekomandimi 5.3:** Nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të refuzohen projektet me analiza të alternativave të prokurimit përkundrejt koncesionimit minimale, të gabuara dhe pa marrë në konsideratë të gjithë elementët e vlerës në kohë të parasë sipas fluskeve dalëse dhe hyrëse. MFE gjatë shqyrtimit përfundimtar të studimit të fizibilitetit të verifikojë dhe vlerësojë nëse janë përmbushur të gjitha kërkesat ligjore të hartimit të një studimi fizibiliteti, në përputhje kjo me nenin 8 të VKM-së nr. 575/2013, të ndryshuar.

**Rekomandimi 5.4:** Nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë ti kërkohet Autoritetit Kontraktues që për këto lloj projektesh që mbartin risqe me efekt të drejtpërdrejtë në Buxhetin

e Shtetit të kryejnë domosdoshmërisht jo vetëm një analizë cilësore të riskut por edhe një analizë sasiore të tij me qëllim që të identifikohet dhe vlerësohet gama e riskut që mund të ndikojë mbi projektin si dhe në drejtim të efekteve të pritshme në Buxhetin e Shtetit. Risku i kursit të këmbimit të shmanget në çdo rast duke mos nënshkruar kontrata në monedha të huaja. Të merren masa të menjëhershme për adresimin e plotë të problematikave të evidentura në studim me efekt në kontratë.

Në çdo rast, miratimi apo refuzimi i projekteve nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, të bëhet vetëm pasi të analizohen efektet në pagesat e kërkuara nga Buxheti i Shtetit duke treguar që flukset e parasë janë brenda mundësisë së përdoruesve dhe autoritetit kontraktues, por edhe në kuadrin e qëndrueshmërisë fiskale.

### **Projekti koncesionar/PPP “Për përmirësimin e infrastrukturës arsimore në Bashkinë Tiranë”.**

**Gjetje nga auditimi** Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve përcjellë me shkresën nr.238/11 prot, datë 09.01.2020, rezultuan të pa zbatuar, në proces zbatimi rekomandimet, si vijon::

**Rekomandimi 6.1:** MFE në analizën e përballeshmërisë së projekteve të përcaktojë efektin e kostove në shtesën për financim duke u siguruar përpara miratimit të projekteve, mbështetur në analizën ekonomike dhe financiare ku objektivi i saj kryesor është të përcaktojë vlerën e parasë së projektit. MFE të refuzojë studimet e fizibilitetit që nuk shprehin një vlerësim të investimit në total, kostot operative dhe të mirëmbajtjes së projektit. Në çdo rast të refuzohen projektet të cilat janë të papërballeshme dhe të pa mbështetura në PBA përkatëse në momentin e miratimit.

**Rekomandimi 6.2:** Nga ana e MFE të refuzohen projektet të cilat e mbështesin arsyetimin e vendimit për dhënien me PPP në të dhëna të paargumentuara, pasi kjo sjell mos konfirmimin e leverdisshmërisë dhe qëndrueshmërisë së projektit.

## **12. INSTITUTI I SIGURIMEVE SHOQËRORE, (TEMATIK PENSIONET E MINATORËVE)**

Auditimi në **Institutin e Sigurimeve Shoqërore** është realizuar në bazë të Programit të Auditimit Nr.694 Prot, datë 16.07.2020 me objekt: Verifikimit i zbatimit të rekomandimeve të dërguara në Institutin e Sigurimeve Shoqërore, Tiranë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit.

Në përfundim të misionit auditues në lidhje me verifikimin e dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga KLSH në Institutin të Sigurimeve Shoqërore, Tiranë me shkresën nr. 919/7, datë 06.01.2020, rezulton në mënyrë të përmbledhur, si më poshtë:

### **KONKLUZIONI I AUDITIMIT**

Nga auditimi tematik mbështetur në standardet e INTOSAI-t, Manualit të Përputhshmërisë, Manualit të ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve së KLSH-së, i kryer në Institutin e Sigurimeve Shoqërore, rezultoi se për rekomandimet e pranuar niveli i zbatimit të tyre plotësisht ose në proces zbatimi, është në vlerën 100%.

Në subjektin e audituar, janë rekomanduar gjithsej (11) masa, nga të cilat janë pranuar (10) masa, nuk janë pranuar (0) masa dhe nuk është shprehur për (1) masë, atë disiplinore e cila nga KLSH është lënë në diskrecion të subjektit e për pasojë konsiderohet e pranuar dhe e zbatuar. Konstatuam se nga (11) masat e rekomanduara dhe të pranuar janë zbatuar plotësisht 8 prej tyre ose 73% , në proces 3 masa, ose 27%.

- Nga 10 masa organizative të rekomanduara, janë pranuar 10 masa organizative, nga të cilat 7 masa janë të zbatuara dhe 3 masa rezultojnë në proces zbatimi.

**Për sa më sipër rikërkojmë që Instituti i Sigurimeve Shoqërore të marrë të gjitha masat e nevojshme me qëllim zbatimin e të gjitha rekomandimeve që rezultuan në proces zbatimi, si vijon:**

## B. MASA ORGANIZATIVE

**1.Gjetje nga auditimi** Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve përcjellë me shkresën nr. 919/7, datë 06.01.2020, rezultuan në proces zbatimi rekomandimet, si më poshtë:

**Rekomandimi 1:** a) ISSH të kalojë në një proces inspektimi/verifikimi dhe më pas dixhitalizimi, të gjithë regjistrat e kërkesave, kthimeve, caktimeve, mbylljeve, të trajtimit të vecantë të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë, të cilat administrohen nga Drejtoritë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore;

b) Në përfundim të procesit të inspektimit/verifikimit, të dokumentacionit të administruar nga DRSSH, ISSH të verifikojë gjithë informacionin e hedhur në sistemin informatik të pensioneve PCAMS, në vitin 2012 dhe rezultatet e këtij procesi t'i pasqyrojë në sistem në një kolonë të veçantë.

**Rekomandimi 8:** a) Strukturat përgjegjëse në ISSH të koordinojnë punën në funksion të, saktësismit dhe detajimit të 991 përfituesve, (dosjet e të cilëve rezultojnë të mbyllura nga auditimi në sistemin informatik të pensioneve PCAMS), nga zbatimi i skemave të Ligjit nr.8685/2000 dhe Ligjit nr.150/2014; b) Pasi të saktësohet statusi i tyre të pasqyrohen veçmas në sistem në kategorinë “Konkluduar sa përfitur padrejtësisht”.

**Rekomandimi 9:** a) ISSH të marrë masa për përmirësimin e Rregullores për Organizimin e Detyrave Funksionale në Drejtorinë e Përgjithshme të ISSH-së dhe Rregullores nr.1/2, datë 04.03.2011 “Për një shtesë në Rregulloren nr.1, datë 21.10.2008 “Për caktimin, administrimin dhe pagesën e pensioneve”, e ndryshuar, në drejtim të reflektimit në to të ndryshimeve strukturore dhe përfshirjes së të drejtës së vendosjes së gjobës, si detyrim që rrjedh nga zbatimi i nenit 5 të Ligjit nr.150/2014; b) Strukturat përgjegjëse të ISSH-së të vlerësojnë në regjistrin e riskut të gjitha problematikat e dala nga Njësia e Inspektimit të Përfitimeve, për pensionet suplementare të minatorëve që paraqesin risk; c) Institucioni të marrë masa që planifikimi i kontrolleve dhe çertifikimi i pensioneve të minatorëve nga Njësia e Inspektimit të Përfitimeve të kryhet jo më vonë se një vit, me qëllim identifikimin në kohë të mangësive dhe dëmeve të shkaktuara në mënyrë që fondet për pensione të përdoren me efektivitet; d) Njësia Përgjegjëse për Inspektimin të marrë masa për përmirësimin rrënjësor të praktikave të punës së inspektimit dhe të kontrollit të brendshëm, me synim garantimin e gjurmës së auditimit dhe realizimin e objektivit të ISSH – së, me fokus luftën kundër informalitetit.

## **III. TË TJERA**

Për të gjitha Rekomandimet që konsiderohen në proces, të pa zbatuara, të zbatuara pjesërisht, në proces zbatimi ose të papranuara të inkurajohet përsheptimi i realizimit të plotë të tyre brenda tremujorit të parë të vitit 2021, verifikimi i zbatimit të të cilave do të kryhet në auditimin e radhës që KLSH do kryejë në këto subjekte.

Për Rekomandimet të cilat kanë rezultuar në proces, të pa zbatuara, të zbatuara pjesërisht, në proces zbatimi ose të papranuara nga auditimi i ushtruar “Për zbatimin e Rekomandimeve të



lëna në auditimet e mëparshme”, së bashku me pjesë nga Raporti Përfundimtar, do të përcillen për secilin subjekt gjatë muajit nëntor 2020, sipas Vendimit të Kryetarit për këtë auditim.

Me ndjekjen dhe zbatimin e detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Shtetit.

**K R Y E T A R I**

**Arben SHEHU**